

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5512
E enjte, 28 qershor 2018
çmimi 0.40 €

Liberia do të hapë ambasadë në Republikën e Kosovës

Ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, është takuar me presidentin e Liberisë, George Weah, me të cilin janë pajtuar për hapjen e ambasadës së këtij shteti në Prishtinë



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

REPUBLIKA E KOSOVËS, NË PRITJE TË
REKOMANDIMIT TË KOMISIONIT
EVROPIAN PËR LIBERALIZIMIN E VIZAVE

Optimizëm për liberalizimin e vizave

FAQE 4-5

Komisioni Evropian (KE) sot (e enjte) pritet ta publikojë raportin për liberalizimin e vizave me Kosovën, mirëpo ky raport ka gjasa të shtyhet për javën e ardhshme për shkak se më 28 dhe 29 qershor mbahet Këshilli i Ministrave, në të cilin zyrtarisht miratohen konkluzionet për Kosovën. "Kosovës i është

thënë se tanimë është çështje ditësh liberalizimi i vizave, gjithsesi para pushimit veror kur edhe Parlamenti Evropian shkon në pushim", kanë thënë burime brenda Qeverisë së Kosovës për gazetën "Epoka e re". Ndërkaq të mërkurën ka qëndruar për vizitë në Prishtinë drejtoresha për

Ballkanin Perëndimor në Drejtorinë e Përgjithshme për Fqinjësi dhe Negociata për Zgjerim në KE, Geneveta Ruiz-Calavera, e cila është takuar me kryeministrin Ramush Haradinaj. Pas takimit me Haradinajn, ajo ka shprehur optimizëm se liberalizimi i vizave për Kosovën do të ndodhë shpejt

Përmbillet procesi i hartimit të projektligjeve për reformimin e administratës publike

Republika e Kosova është në fazën finale të hartimit të tri projektligjeve kryesore për reformimin e administratës publike. Kështu është thënë të mërkurën në tryezën me temë "Sfidat

në reformën e administratës publike: Ku qëndron Kosova?" të organizuar nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS). Zyrtarët shtetërorë kanë bërë me dije se me miratimin e

Projektligjit të administratës shtetërore, Projektligjit për zyrtarët publikë dhe Projektligjit për pagat realizohen aspiratat për një shtet modern evropian



Me ligjin e ri paga e mjekëve të përgjithshëm do të jetë 717 euro



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Curez-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

AKTUALE

600 MIJË PYETJE F. 11

Pandeli MAJKO



HAPËRIMI I KUJDESTARIT TË PRIVATËSISË F. 11

Jeton ARIFI



SHQIPËRISË I KËRKOHEM TA SHTOJË RITMIN E REFORMAVE F. 2

STABILIZOHET GJENDJA E FURNIZIMIT ME BARNË NË QKUK F. 7

EKONOMI

AUDITORI I PËRGJITHSHËM VLERËSON KUVENDIN E KOSOVËS PËR TRANSPARENCË F. 9

KOSOVA DHE MALI I ZI, TË GATSHËM PËR T'I HEQUR BARRIERAT EKONOMIKE F. 9

SPORT

KOSOVA RRËMBEN DY MEDALJE TË ARTA NË LOJËRAT MESDHETARE F. 21

KOREJA ELIMINON GJERMANINË, KUALIFIKOHEN SUEDIA DHE MEKSIKA F. 21

Vuçiqi: Do të dal para popullit dhe ta them propozimin tim për Kosovën

BEOGRAD, 27 QERSHOR - Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka thënë se do të dalë para popullit me propozim për "zgjidhjen e përhershme të çështjes së Kosovës" dhe se populli pastaj

do të vendosë për të ardhmen e tij. "Nuk ka asgjë të bukur për Kosovën që mund të ofrojmë apo të fitojmë. Vetëm mundime dhe gjëra të vështira. Por, unë do të dal para popullit dhe do ta

them propozimin tim. Nuk do të fshihem dhe populli do ta sjellë vendimin për të ardhmen e vet", u ka thënë Vuçiqi gazetarëve në Kralejë, transmeton Shërbimi i Ballkanit i "Radios

Evropa e Lirë". Vuçiqi ka theksuar se vendimi për referendum do të merret pasi të arrihet një zgjidhje kompromisi, e cila nuk do të jetë në kurriz të qytetarëve.



Liberia do të hapë ambasadë në Republikën e Kosovës



LIBERI, 27 QERSHOR (ER) - Ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, është takuar me presidentin e Liberisë, George Weah, me të cilin janë pajtuar për hapjen e ambasadës së këtij shteti në Prishtinë. "Takimi me presidentin e Liberisë, George Weah, ishte i përzemërt dhe në frymën e miqësisë dhe bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet dy vendeve. Ndër të tjera, me presidentin Weah u pajtuam për

hapjen e Ambasadës së Liberisë në Prishtinë, ndërsa bashkëpunimin tonë ndërshtetëror do ta ngrehim në nivelin më të lartë", ka shkruar Pacolli në llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka thënë se presidenti Weah ka theksuar qartë se Liberia, si një ndër shtetet e para që ka njohur Kosovën, do të jetë fuqishëm në mbështetje të anëtarësimit të vendit tonë në organizata të rëndësishme

botërore. "Weah, i cili ka qenë dikur edhe fitues i 'Topit të Artë' të Evropës, sa ka qenë lojtar i Milanit, u shpreh i gatshëm që bashkë me ekipin kombëtar të Liberisë të zhvillojë një ndeshje miqësore me përfaqësuesen e Kosovës në futboll. Presidenti Weah, i cili është edhe mik imi i vjetër, pranoi me kënaqësi ftesën për ta vizituar Republikën e Kosovës", ka shkruar Pacolli.

Shqipërisë i kërkohet ta shtojë ritmin e reformave

Përfaqësues të Bashkimit Evropian dhe të ShBA-së kanë përgëzuar Shqipërinë për vendimin pozitiv në lidhje me hapjen e bisedimeve për anëtarësim në BE. Ata kanë theksuar se Shqipëria ka bërë përparim domethënës dhe tani nevojitet t'i rrisë përpjekjet për t'i përfunduar reformat kyçe në këtë proces



TIRANË, 27 QERSHOR - Eurodeputeti slovak Eduard Kukan ka bërë me dije se Shqipërisë dhe Maqedonisë u është dhënë një vit kohë për të shkuar më pas në tryezën e negociatave. Ai ka thënë se dy vendet meritojnë një mesazh të qartë për hapjen e negociatave, ndërsa ka theksuar se do të punojë gjatë kësaj kohe me partnerët nga dy vendet. "Unë përshëndes konkluzionet e Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme të djeshme për hapjen e rrugës për negociatat e pranimit me Shqipërinë dhe Maqedoninë. Unë dua t'i përgëzoj të dy vendet për përparimin e bërë në agjendën e integritimit në BE. Ata meritojnë një mesazh të qartë për fillimin e negociatave të pranimit. Këtyre

vendeve u është dhënë një vit kohë të vijë në tryezën e negociatave, që pasqyron diskutimin e brendshëm të Këshillit mbi procesin e zgjerimit të BE. Unë mbështes plotësisht Shqipërinë dhe Maqedoninë në këtë proces dhe i besoj angazhimit të tyre në agjendën e reformave. Unë pres që të punoj me partnerët tanë gjatë muajve të ardhshëm dhe jam gati të ec me ta në rrugën drejt negociatave të pranimit", ka thënë Kukan në një deklaratë për medie.

Pas vendimit të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian për hapjen e negociatave me Shqipërinë vitin e ardhshëm, ka reaguar edhe Ambasada Amerikane në Tiranë. Selia diplomatike amerikane ka përgëzuar Shqipërinë për mar-

rjen e një afati zyrtar për nisjen e negociatave. Ambasada Amerikane në Shqipëri ka vlerësuar ecurinë e reformave të bëra deri më tani dhe ka bërë thirrje për luftimin e krimit. "Përgëzojmë

Shqipërinë për vendimin pozitiv në lidhje me hapjen e bisedimeve për anëtarësim në BE. Shqipëria ka bërë përparim domethënës dhe tani nevojitet t'i rrisë përpjekjet për t'i përfunduar reformat kyçe. Ne e

nxisim Shqipërinë që ta rrisë ritmin në reformën në drejtësi, luftën kundër korrupsionit dhe kundër krimit të organizuar", thuhet në deklaratën e Ambasadës Amerikane në Shqipëri.

Rama: Shqipëria nuk pranon hapjen e qendrave për migrantë

TIRANË, 27 QERSHOR - Shqipëria refuzoi hapjen e qendrave për migrantët që synojnë të hyjnë në Bashkimin Evropian, duke thënë se njerëzit nuk duhen trajtuar si "mbetje toksike". Në kuadër të përpjekjeve për të frenuar të ardhur të rinj,

udhëheqësit e BE-së shpresojnë të ngrënë kampe jashtë bllokut për t'i përpunuar kërkesat për azil.

Pasi Shqipëria është në kufi me Greqinë, ndërsa prej Italisë e ndan Deti Adriatik, ajo është konsideruar si vend i mund-

shëm për qendrat e tilla të azilit. Por, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, e hodhi poshtë idenë në një intervistë për të përditshmen gjermane "Bild". "Nuk do të pranojmë kurrë kampe të tilla refugjatësh", ka thënë Rama, duke paralajmëruar se

shndërrimi i Shqipërisë në një port për refugjatët e Evropës është zgjidhje e rrezikshme. "Qendrat e tilla nënkuptojnë hedhjen e njerëzve të dëshpëruar diku, si mbetje toksike që askush nuk i do", ka thënë Rama.



Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) ka mbajtur tryezën me temë "Sfidat në reformën e administratës publike: Ku qëndron Kosova?"

Përmbillet procesi i hartimit të projektligjeve për reformimin e administratës publike

Republika e Kosovës është në fazën finale të hartimit të tri projektligjeve kryesore për reformimin e administratës publike. Kështu është thënë të mërkurën në tryezën me temë "Sfidat në reformën e administratës publike: Ku qëndron Kosova?" të organizuar nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS). Zyrtarët shtetërorë kanë bërë me dije se me miratimin e Projektligjit të administratës shtetërore, Projektligjit për zyrtarët publikë dhe Projektligjit për pagat realizohen aspiratat për një shtet modern evropian

**EPOKA
ERE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 27 QERSHOR - Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) të mërkurën ka mbajtur tryezën me temë "Sfidat në reformën e administratës publike: Ku qëndron Kosova?", ku është diskutuar për sfidat dhe ecurinë e procesit të reformimit të administratës publike. Me këtë rast, ministri i Administratës Publike (MAP), Mahir Jaghillar, ka bërë me dije se, pas një pune intensive, kjo ministri është në përmblyllje të procesit të hartimit të tri projektligjeve kryesore për reformimin e administratës publike. "Ne tashmë jemi në fazën finale të hartimit të projektligjeve kryesore të reformës së administratës publike, përkatësisht të Projektligjit të administratës shtetërore, Projektligjit për zyrtarët publikë dhe Projektligjit për pagat. Përmes këtyre tri projektligjeve ndërtohet një bazë legislative për një shtet modern evropian, për zhvillimin e një mjedisi të

përshtatshëm dhe për integrimin evropian. Projektligjet tashmë janë në fazën përfundimtare të procedimeve publike dhe ne si ministri jemi duke zhvilluar një fushatë të gjerë të informimit dhe gjithëpërfshirjes së institucioneve të ndryshme dhe shoqërisë civile në procesin e vendim-marrjes", ka deklaruar Jaghillar. Po ashtu, ai ka treguar se Qeveria e Republikës së Kosovës me prioritet është duke u marrë edhe me çështjen e zvogëlimit të agjencive të pavarura dhe, sipas ministrit, është faza finale e hartimit të planit të veprimit të zbatimit të rishikimit të agjencive. Edhe koordinatori për reforma shtetërore, Besnik Tahiri, në diskutimin e tij ka theksuar se institucionet e Republikës së Kosovës tashmë janë duke përmblyllur procesin e hartimit të pakos së ligjeve të administratës publike, proces ky që, sipas tij, ka kaluar në një tranzicion të gjatë dhe të mundimshëm. "Nga pas lufta Kosova ka trashëguar një kor-



pus të nëpunësve të përjashtuar nga sistemi në vitet e '90-ta, në po atë periudhë kur janë promovuar parimet e qeverisjes së mirë. Po ashtu, sfidauese ka qenë edhe faza e bartjes së kompetencave nga UNMIK-u tek institucionet vendore. Mungesa e politikave dhe legjislacionit ka krijuar një sistem të fragmentuar, duke mbivendosur institucione, procedura dhe procese", ka theksuar Tahiri. Ai ka shtuar se tashmë, në këtë fazë pas miratimit të pakos, institucionet e vendit po hapin një kapitull të ri, perspektivë ku do të ketë fokus standardizimi i procedurave, vendosja e qartë e hierarkisë dhe llogaridhënies, si dhe në mënyrë progresive do të ndikojë në rritjen e miritokracisë dhe kthimin e besimit në konkurs. "Para së gjithash, është e rëndësishme të nisim një fazë të avancimit profesio-

al dhe rritjen e integritetit si mekanizëm kyç në parandalimin e korrupsionit dhe trasimin e rrugës për zhvillim dhe rrugëtim evropian", është shprehur Tahiri. Ndërkohë zëvendësministri i Financave, Fatmir Gashi, ka thënë se duhet më shumë punë për ndërtimin e kompetencave të institucioneve, pastaj të mendohet rreth planifikimit më të gjatë të menaxhimit objektiv. "Ministria e Financave është e para sivjet që e ka bërë një bashkëpunim me USAID-in për ta bërë vlerësimin e ligjit të TVSh-së dhe zbatimin e MSA-së. Në vlerësimin që e kemi bërë për TVSh-në kemi ardhur në përfundim që me ndryshime ligjore buxheti ka përfituar rreth 50 milionë euro dhe, siç është thënë, ngritja e çmimit nuk ka ndodhur, por është konstatuar edhe me MSA-në dhe do

të shohim për çdo vjet se MSA-ja çfarë ndikimi ka në buxhet", ka deklaruar Gashi. Ndërsa Albana Rexha nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) ka thënë se reformimi i administratës publike është parakusht për implementimin e suksesshëm për politika të ndryshme. "Në vitin 2017 ekzistojnë 60 strategji sektoriale. Ky numër ka qenë edhe më i madh në vitet e kaluara dhe të gjitha këto janë në linjë me prioritetet qeveritare dhe jo të gjitha janë të buxhetuara", ka thënë Rexha. Gjithashtu, në këtë tryezë Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) ka prezantuar të gjeturat dhe rekomandimet e analizës së politikave me titullin: "Sistemi i politikëbërjes në Kosovë: Një pikëpamje mbi sfidat sistematike dhe drejtimet potenciale të reformës".

NATO-ja në Kosovë, e nevojshme

PRISHTINË, 27 QERSHOR (ER) - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, ka zhvilluar të mërkurën një takim me udhëheqësit e Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s (NALT), kryesuar nga drejtori gjeneral Ralf Hoffmann.

Në këtë takim është biseduar për tranzicionin e FSK-së në Forca të Armatosura, për mbështetjen e paqes dhe të sigurisë për të gjithë, për domosdoshmërinë e vazhdimin të pranisë së NATO-s në Kosovë si dhe për bashkëpunimin tonë të rregullt për forcimin e institucioneve të sigurisë. Duke theksuar kontributin e Kosovës në sigurinë rajonale

dhe profesionalizmin e institucioneve të sigurisë, kryeministri Haradinaj ka theksuar përkushtimin që Kosova në një të ardhme të afërt të jetë pjesë e Aleancës Veri-Atlantike. "Një ushtri e modeluar sipas kriterëve të NATO-s, profesionale dhe gjithëpërfshirëse, do të jetë aleat i besueshëm e kredibil për siguri dhe paqe të qëndrueshme në rajonin tonë dhe më gjerë", ka thënë kryeministri Haradinaj.


Drejtori i NALT-it, gjenerali Ralf Hoffmann, ka falënderuar kryeministrin Haradinaj për pritje, duke shprehur gatishmërinë për vazhdimin e bashkëpunimit edhe në të ardhmen.



Republika e Kosovës, në pritje të rekomandimit të Komisionit Evropian për liberalizimin e vizave

Optimizëm për libe

Komisioni Evropian (KE) sot (e enjte) pritet ta publikojë raportin për liberalizimin e vizave me Kosovën, mirëpo ky raport ka gjasa të shtyhet për javën e ardhshme për shkak se më 28 dhe 29 qershor mbahet Këshilli i Ministrave, në të cilin zyrtarisht miratohen konkluzionet për Kosovën. "Kosovës i është thënë se tanimë është çështje ditësh liberalizimi i vizave, gjithsesi para pushimit veror kur edhe Parlamenti Evropian shkon në pushim", kanë thënë burime brenda Qeverisë së Kosovës për gazetën "Epoka e re". Ndërkaq të mërkurën ka qëndruar për vizitë në Prishtinë drejtoresha për Ballkanin Perëndimor në Drejtorinë e Përgjithshme për Fqinjësi dhe Negociata për Zgjerim në KE, Genoveva Ruiz-Calavera, e cila është takuar me kryeministrin Ramush Haradinaj. Ajo pas takimit me Haradinajn ka shprehur optimizëm se liberalizimi i vizave për Kosovën do të jetë një realitet i shpejtë



EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 27 QERSHOR - Drejtoresha për Ballkanin Perëndimor në Drejtorinë e Përgjithshme për Fqinjësi dhe Negociata për Zgjerim në Komisionin Evropian, Genoveva Ruiz-Calavera, ka shprehur optimizëm se qytetarët e Kosovës do të mund të lëvizin së shpejti pa viza. Pas takimit me kryeministrin Ramush Haradinaj, ajo ka

thënë të mërkurën se shumë shpejt Bashkimi Evropian do të dalë me një propozim i cili mund ta bëjë liberalizimin e vizave realitet. "Shpresoj që shumë shpejt Komisioni Evropian do të dalë me një propozim që liberalizimin e vizave ta bëjmë realitet", ka thënë Ruiz-Calavera në një konferencë për medie.

Edhe kryeministri Ramush Haradinaj ka shprehur optimizëm se rekomandimi për liberalizim të vizave do të jetë pozi-

tiv për Kosovën. "Së shpejti komisioni do ta japë propozimin e vet. Besojmë që shpejt do ta kemi vlerësimin pozitiv. Një prej punëve që do ta bëjmë me kujdesin më të madh është që mos të mbërrijnë porosi të gabuara për Kosovën. Nuk ju shkojnë prej Kosovës as refugjatët, as kriminelët", ka thënë Haradinaj.

Ndërkaq sot (e enjte) Komisioni Evropian (KE) pritet ta publikojë raportin për liberalizimin e

vizave me Kosovën, mirëpo ky raport ka gjasa të shtyhet për javën e ardhshme për shkak se më 28 dhe 29 qershor mbahet Këshilli i Ministrave, në të cilin zyrtarisht miratohen konkluzionet për Kosovën. "Kosovës i është thënë se tanimë është çështje ditësh liberalizimi i vizave, gjithsesi para pushimit veror kur edhe Parlamenti Evropian shkon në pushim", kanë thënë burime brenda Qeverisë së Kosovës për gazetën

"Epoka e re".

Gjatë vizitës në Prishtinë, drejtoresha për Ballkanin Perëndimor në Drejtorinë e Përgjithshme për Fqinjësi dhe Negociata për Zgjerim në KE, Genoveva Ruiz-Calavera, ka kërkuar nga kryeministri Haradinaj që Kosova të fokusohet në implementimin e Agjendës së Reformës Evropiane. Ajo ka shprehur mbështetjen e Komisionit Evropian për realizimin e këtyre reformave. "Vizita

Realizimin e vizave

reformës ekonomike ne jemi duke punuar së bashku", ka thënë ajo, duke treguar për reformat që duhet t'i ndërmarrë Kosova. "Janë reforma të rëndësishme nga fusha e sundimit të ligjit, qeverisjes së mirë, konkurrenca, klima për investime, po ashtu edukimi dhe punësimi të cilat janë shumë të rëndësishme për Kosovën që ta vazhdojë përparimin", ka thënë zyrtarja e KE-së, Genoveva Ruiz-Calavera. Ajo ka përmendur një nga kërkesat kryesore të Bashkimit Evropian, reformën e administratës publike. "Ne kemi bisedime për disa shtetësi që i kemi në disa fusha në të cilat ka nevojë për përparime. Në përgjithësi ne duhet ta kuptojmë se të gjitha vendimet që ndërmerren nga Qeveria duhet të jenë shumë kohezive, duke shtyrë këtë agjendë përpara, në veçanti në reformën e administratës publike. Ne duhet të sigurohemi se vendimet që merren e sigurojnë qëndrueshmërinë e shteteve", ka deklaruar Ruiz-Calavera.

Ndërsa kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se Kosova është e përkushtuar për përmbylljen e kriterëve dhe agjendës evropiane. "Biseda ka qenë e fokusuar në prioritetet e agjendës evropiane për Kosovën në reformat, në rend

Ministrja Hoxha: Jemi në pritje të rekomandimit pozitiv të Komisionit Evropian

Ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se Kosova ka përmbyllur të gjitha kushtet e kërkuara për liberalizim të vizave. "Kosova ka pasur udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave që nga viti 2012 dhe kemi pasur 95 kriteret, më shumë se të gjitha vendet e rajonit. Institucionet tona kanë treguar përkushtim dhe konsideroj se me ratifikimin e demarkacionit kemi përmbyllur kushtet e dhëna. Po ashtu, kemi progres në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, gjë e cila do të vazhdojë edhe pas liberalizimit të vizave", ka thënë



Hoxha, duke shtuar se Kosova e meriton një rekomandim pozitiv nga Komisioni Evropian. "Tani jemi në pritje të rekomandimit të Komisionit Evropian i cili pres të jetë pozitiv duke marrë parasysh punën që

kemi bërë dhe përmbylljen e kushteve të kërkuara. Pas rekomandimit pozitiv duhet të bëhet miratimi në PE dhe jam duke punuar intensivisht për ta marrë përkrahjen e të gjitha shteteve. Në funksion të kësaj ishte edhe vizita ime në Bruksel, ku takova sekretarin e shtetit për Migracionin si dhe disa eurodeputetë. Qytetarët e Kosovës e meritojnë lëvizjen e lirë dhe duhet ta kenë. Ne politikanët jemi në shërbim të qytetarëve dhe besoj se me punën dhe angazhimin e përbashkët do të arrijmë progres në rrugën drejt integritimit", është shprehur ministrja Hoxha.

dhe ligj, por edhe në administratën publike dhe arsim. Biseduam edhe për punët e kryera, por edhe për punët që i kemi para vetes. Jam thellë i bindur se në javët që vijnë, edhe nga sugjerimet e drejtoreshës për zgjerim, do të shënojmë rezultate pikërisht në ato që

janë sot tema kyçe", u shpreh kryeministri Haradinaj. Pas takimit me kryeministrin Ramush Haradinaj, Genoveva Ruiz-Calavera është takuar me shefat e grupeve parlamentare të partive politike, ministrat relevantë lidhur me agjendën e reformës evropiane, si dhe me

përfaqësues të shoqërisë civile. Kosova pret që deri në dhjetor të përmbyllet i gjithë procesi sa i përket liberalizimit të vizave. Sipas këtyre pritjeve, qytetarët e Kosovës do të mund të lëvizin lirshëm pa viza në Zonën Shengen nga janari, përkatësisht shkurti i vitit 2019.

Ministri Tahiri: Fuqizimi i sundimit të ligjit, i paalternativë

Faton DERMAKU

PRISHTINË, 27 QERSHOR - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, është takuar të mërkurën me drejtoreshën për Ballkanin Perëndimor në Drejtorinë e Përgjithshme për Fqinjësi dhe Negociata për Zgjerim në Komisionin Evropian, Genoveva Ruiz-Calavera. Në takim, ku ishin pjesëmarrës edhe ministri i Administratës Publike, Mahir Jagxhillar, ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyçi dhe anëtarë të tjerë të kabinetit qeveritar, u diskutua lidhur me përmbylljen e Agjendës së Reformës Evropiane. Ministri Tahiri me këtë rast ka njoftuar drejtoreshën Ruiz-Calavera se tashmë Ministria e Drejtësisë ka përmbyllur obligimet e dala nga Agjenda e Reformave Evropiane, duke

hartuar edhe Pakon e Ligjeve për Gjyqësorin, Pakon e Ligjeve Kundër Korrupsionit, si dhe nisjen e procesit të Rishikimit Funkcional të Sektorit të Sundimit të Ligjit. "Fuqizimi i sundimit të ligjit në Kosovë është i paalternativë dhe ndërlidhet me ndërtimin e rrugës drejt integritimit në Bashkimin Evropian. Kjo nënkupton që puna jonë është dhe do të bëhet edhe më e vështirë, pasi nënkupton përmbylljen e pritshmërive që vetë i kemi vendosur, në mënyrë që të arrijmë rezultate për vendin tonë. Këto rezultate nënkuptojnë bërjen e gjyqësorit më efikas, përmirësim në fushën e respektimit të të drejtave njerëzore, luftimit me sukses të korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe krijimit të një atmosfere të duhur për të bërë biznes dhe për tërheqjen e investimeve të huaja", ka thënë ministri Tahiri.



Gjatë raportimit, ministri Tahiri ka pohuar se në punën në ndryshimet ligjore janë udhëzuar nga parimet mbi të cilat është ndërtuar Bashkimi Evropian. "Ministria e Drejtësisë gjatë hartimit të legjislacionit ka marrë si udhëzues parimet mbi të cilat është ndërtuar vetë Bashkimi Evropian, duke hartu-

ar norma ligjore që respektojnë të drejtat njerëzore dhe liritë themelore, duke përfshirë masa që luftojnë korrupsionin si dhe duke iniciuar aktivitete siç është rishikimi funksional i sektorit të sundimit të ligjit, që do ta fuqizojë sistemin e drejtësisë në Kosovë", ka thënë ministri Tahiri.

ime në Prishtinë ka të bëjë me pasqyrimin se ku jemi si Kosovë dhe BE, përkatësisht në implementimin në Agjendën e Reformës Evropiane, konkretisht në reformat e rëndësishme në sundimin e ligjit, qeverisjes së mirë, edukimit dhe punësimit, që janë tejet të rëndësishme. Ne kemi parë progres dhe kemi diskutuar për punën dhe sfidat që na presin. Jam shumë e lumtur që në Agjendën e Reformës Evropiane dhe në programin e

Interesim i kënaqshëm i qytetarëve për takimin publik me kryetarin Bahtiri

MITROVICË, 27 QERSHOR (ER) - Të mërkurën kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka mbajtur tubimin e parë publik me qytetarë për këtë vit, ku është diskutuar rreth punës së ekzekutivëve të komunës në periudhën e parë gjashtëmujore të vitit 2018. Në takim kanë marrë pjesë nënkryetari i komunës, Faruk Mujka dhe të gjithë drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësues të shoqërisë civile, si dhe rreth 100 qytetarë.

Kryetari Bahtiri dhe drejtorët e drejtorive komunale i kanë njoftuar qytetarët për punën që kanë bërë dhe për realizimin e projekteve të planifikuara, ndërsa që qytetarët kanë shtruar pyetje lidhur me çështje të ndryshme të tyre.

Pasi i falënderoi për pjesëmarrje në takim në numër të konsiderueshëm, kryetari Bahtiri u tha atyre se këtë tubim e ka thirrur me qëllim që të njofto-

hen për punën që po bëhen në Komunën e Mitrovicës, për problemet dhe sfidat me të cilat po ballafaqohen në punën e përditshme, si dhe që qytetarët e Mitrovicës të kenë mundësi të shprehen, t'i japin vërejtjet e tyre dhe të parashtrorjnë kërkesa, të cilat, nëse janë të arsyeshme dhe të pranueshme, gjithsesi se do të realizohen.

Në vazhdim kryetari Bahtiri u tha qytetarëve se ekzekutivi i komunës dhe shërbyesit civilë të saj kanë bërë punë dhe shërbime të mira për ta gjë që, sipas tij, tregon edhe kënaqshmëria gjithnjë në rritje e tyre për shërbimet që ata i marrin në komunë dhe për premtimet e mbajtura nga drejtuesit komunalë. "Tani kur Komuna e Mitrovicës është një ndër komunat më të sigurta në vend, kur nuk kemi tensione dhe trazira, ju kemi kthyer me përkushtim realizimit të objek-



tivave që kemi shtruar para qytetarëve të komunës. Sot Mitrovica ka ndryshuar tërë-

sisht për të mirë. Në Mitrovicë vijnë qytetarë nga të gjitha viset e vendit për t'i parë projektet e

shumta që kemi realizuar, siç është liqeni artificial shëtitorja e qytetit etj", ka thënë Bahtiri.

Stabilizohet gjendja e furnizimit me barna në QKUK

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 27 QERSHOR - Shërbimi farmaceutik i Barnatores Qendrore në Qendrën Klinike dhe Universitare të Kosovës (QKUK) ka dalë me shifra pozitive sa i përket furnizimit me barna dhe material shpenzues për institucionet publike shëndetësore. Sipas kësaj barnatoreje, pas nënshkrimit të kontratave të reja, tashmë ka nisur edhe liferimi i barnave të ndryshme nëpër institucionet shëndetësore, dhe tani furnizimi është stabilizuar duke bërë që qytetarët t'i marrin barnat



në kohë dhe falas.

Referuar statistikave zyrtare të kësaj barnatoreje, tani furnizi-

mi me barna është mbi 70 për qind, me pritjen reale që brenda pak kohe kur të nisin edhe

liferimet e tjera kjo përquindje të jetë edhe më lart. Kjo barnatore është furnizuar edhe me anestetikë për nevojat dhe kërkesat e të gjitha klinikave dhe spitaleve, në mënyrë që të gjitha sallat operative të jenë funksionale dhe në krye të detyrës.

Në të njëjtën kohë, është bërë me dije se edhe me material shpenzues gjendja e stoqeve është stabilizuar dhe nuk bëhet fjalë për mungesa të materialeve bazike, si: penj, kanilla, dorëza, gjilpëra etj. Ndërsa sipas zyrtarëve të Ministrisë së Shëndetësisë, së fundmi janë lidhur dhjetëra kontrata me çmime më të lira se ato para-

praket, të cilat jo vetëm se kanë kursyer buxhetin e shtetit, por do të sigurojnë edhe më shumë barna për pacientë.

Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës (FSSHK) i është gëzuar informacionit nga ana e Barnatores Qendrore për fillimin e furnizimit me barna. "Presim që në ditët dhe javët në vijim kjo përquindje të rritet dhe situata të stabilizohet. Gjithashtu, ministri i Shëndetësisë ka premtuar që kontratat që lidhen në vijim do të jenë në interes të qytetarëve dhe do të kenë kujdes të veçantë ruajtjen e buxhetit", është thënë në njoftimin e FSSHK-së.

AAK-ja inicion projektrezolutën për shtesat e fëmijëve në Kosovë

PRISHTINË, 27 QERSHOR (ER) - Deputetja e Kuvendit të Kosovës nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Donika Kada-Bujupi, ka bërë me dije se në emër të grupit parlamentar të kësaj partie sot ka dorëzuar projektrezolutën për shtesat e fëmijëve në Kosovë. Ajo ka shprehur bindjen se kjo iniciativë do të mbështetet nga të gjithë deputetët jo veç pse është premtim i kryeministrit Ramuh Haradinaj por sepse, sipas Kada-Bujupit, ky parim i universalitetit dhe solidaritetit familjar në shtesat për fëmijë, sot është interes i përgjithshëm i Kosovës dhe përtej kësaj e drejtë e pakontestueshme për këtë kategori. "Shtesa për çdo fëmijë në Republikën e Kosovës. Sot,

në emër të grupit parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, dorëzova projektrezolutën për shtesat për të gjithë fëmijët e Republikës së Kosovës. Një nismë drejt dinamizimit të politikave familjare. Të bindur se kjo iniciativë do të mbështetet nga të gjithë deputetët, jo veç pse është premtim i kryeministrit Haradinaj, por sepse ky parim i universalitetit dhe solidaritetit familjar në shtesat për fëmijë sot është interes i përgjithshëm i Kosovës dhe, përtej kësaj, e drejtë e pakontestueshme për këtë kategori. Reformë e sistemit, solidaritet familjar. Vazhdojmë", ka shkruar Kadaj-Bujupi në llogarinë e vet në "Facebook".



Me ligjin e ri paga e mjekëve të përgjithshëm do të jetë 717 euro

Projektligji për pagat, i cili është në dëgjim publik së bashku edhe me dy projektligje që rregullojnë fushën e administratës shtetërore, shumë shpejt pritet të votohet në Qeverinë e Kosovës dhe të përcillet për shqyrtim dhe miratim në Kuvend. Pas miratimit të këtij projektligji në Kuvend, mjeku specialist do ta ketë pagën 956 euro, mjeku në specializim 788 euro, ndërsa mjeku i përgjithshëm 717, po aq sa edhe farmacisti i diplomuar

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 27 QERSHOR - Ministria e Administratës Publike (MAP) është duke mbajtur dëgjime publike për tri projektligje të rëndësishme, atë për Administratën Shtetërore, Projektligjin për Zyrtarët Publikë si dhe Projektligjin për Pagat. Projektligji i ri për pagat të cilin e ka siguruar gazeta "Epoka e re",

parasheh nivelimin e pagave për të gjithë zyrtarët shtetërorë që marrin pagë nga buxheti i shtetit. Kurse për këtë projektligj, koeficienti bazë llogaritet të jetë 239 euro. Në bazë të këtij projektligji mjeku specialist (eksperti i mjekësisë ligjore dhe pozita e ngjashme në shëndetësi, në institucionet shëndetësore dhe institucionet e tjera ku ushtrohet profesioni përkatës), do ta ketë koeficientin 4 që,

shumëzuar me koeficientin bazë prej 239 eurosh, kjo kategori do të marrë pagë mujore 956 euro. Kurse për pozitën mjek në specializim koeficienti do të jetë 3.30, me pagë mujore 788.7 euro.

Për pozitën mjek i përgjithshëm (në institucionet shëndetësore dhe institucionet e tjera ku ushtrohet profesioni përkatës), koeficienti do të jetë 3, kurse paga mujore do të jetë 717 euro.

Po ashtu, koeficienti tre llogaritet të jetë edhe për farmacist i diplomuar.

Për pozitën infermier/mami/teknik mjekësor 1 (në institucionet shëndetësore dhe institucionet e tjera ku ushtrohet profesioni përkatës) koeficienti do të jetë 2.15 dhe paga mujore do të jetë 513.85 euro, kurse për pozitën infermier/mami/teknik mjekësor 2 (në institucionet shëndetësore dhe institucionet e tjera ku ushtrohet profesioni përkatës; teknik i autopsisë) koeficienti llogaritet të jetë 1.95 dhe paga mujore do të jetë 466.05 euro. Ndërkaq për pozitën infermier/mami/teknik mjekësor 3 (në institucionet shëndetësore dhe institucionet

e tjera ku ushtrohet profesioni përkatës) koeficienti do të jetë 1.90, ndërsa paga mujore do të jetë 454.1 euro.

Për pozitën infermier/mami/teknik mjekësor 4 (në institucionet shëndetësore dhe institucionet e tjera ku ushtrohet profesioni përkatës, teknik i farmacisë) koeficienti do të jetë 1.70, me pagë mujore 406.3 euro. Për pozitën teknik farmacist koeficienti do të jetë 1.60 dhe paga mujore do të jetë 382.4 euro. Kurse për asistentët e infermierisë (pozitat profesionale në shërbimin civil dhe pozitat profesionale të nëpunësve të shërbimeve publike), koeficienti do të jetë 1.45, paga mujore do të jetë 346.55 euro.



Pritje shtetërore për Reshitajn në shtetin që ende nuk e ka njohur Kosovën

DA NANG, 27 QERSHOR (ER) - Me ftesë të veçantë të Qeverisë së Vietnamit dhe të Fondit Global të Mjedisit (Global Environment Facility - GEF), ministrja e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj, po merr pjesë në Asamblenë e gjashtë të GEF-it që po mbahet këto ditë në Da Nang të Vietnamit.

Në margjina të Asamblesë së GEF-it, ministrja Reshitaj është pritur në një takim nga kryeministri i Vietnamit, Nguyen Xuan Phuc, i cili është edhe takimi i parë shtetëror i një delegacioni kosovar në shtetin e Vietnamit, Qeveria e të cilit ende nuk e ka njohur Kosovën shtet të pavarur



dhe sovran. Në këtë takim ministrja Reshitaj ka theksuar të arriturat e përgjithshme të Republikës së Kosovës, në

veçanti në fushën e mjedisit dhe planifikimit hapësinor.

Reshitaj ka falënderuar kryeministrin vietnamez për ftesën për pjesëmarrje në Asamblenë e Gjashtë të GEF-it dhe ka deklaruar se është nevojë e kohës bashkëpunimi i mëtutjeshëm ndërinstytucional i të dy shteteve. Ajo ka ripërsëritur kërkesën e bërë nga ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, për njohjen e pavarësisë së Kosovës nga Qeveria e Vietnamit, pasi kjo do t'i kontribuonte stabilitetit gjeopolitik të rajonit dhe do ta hapte rrugën e bashkëpunimit në mes dy shteteve në fushën ekonomike, politike e mjedisore.

Falë angazhimit të ministres Reshitaj dhe lobimit të vazhdueshëm të ministrit Pacolli, Kosova ka arritur që për herë të parë të marrë pjesë në Asamblenë e Fondit Global të Mjedisit.

Ky është hapi i parë institucional në drejtim të konsolidimit të pjesëmarrjes të Kosovës në këtë Fond, i cili do të pasohet edhe me hapa të tjerë që do të kontribuojnë në përfitimin e projekteve milionëshe nga fusha e mjedisit, të munguara deri më tani. GEF-i ka një buxhet vjetor mbi 18 miliardë dollarë dhe deri më tani në formë të granteve ka investuar mbi 69 miliardë dollarë në 170 vende të botës.

Hasani ua prezanton bizneseve italiane kushtet e Kosovës për investime të huaja

ROMË, 27 QERSHOR (ER) - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Bajram Hasani, para bizneseve italiane ka prezantuar mundësitë që ofron Kosova për investime në Forumin për Investime Kosovë

- Itali. Me këtë rast, ministri Hasani u ka treguar përfaqësuesve të bizneseve se Kosova ka punuar shumë për lehtësimin e politikave fiskale dhe për eliminimin vështirësive administrative. "Patëm

mundësinë para bizneseve italiane t'i prezantojmë mundësitë që ofron Kosova për investime në Forumin për Investime Kosovë - Itali. Ky forum i cili u mbajt në Padova, u organizua nga Ambasada e Republikës së

Kosovës në Romë në bashkëpunim me Dhomën e Tregtisë në Padova Promex dhe Odën e Tregtisë Itali - Kosovë. Para bizneseve italiane prezantova kushtet që ofron vendi ynë. U tregova se kemi punuar

shumë për lehtësimin e politikave fiskale, potencialet që ofron Kosova për investimet e huaja dhe për punën që kemi bërë për eliminimin e vështirësive administrative", ka bërë me dije ministri Hasani.



Auditori i Përgjithshëm vlerëson Kuvendin e Kosovës për transparencë

PRISHTINË, 27 QERSHOR (ER) - Auditori i Përgjithshëm ka publikuar raportin vjetor për menaxhimin e financave publike në Kuvendin e Kosovës. Sipas këtij raporti, Kuvendi i Kosovës është vlerësuar me notë pozitive për menaxhimin dhe shpenzimin e parasë publike.

Raporti i Auditorit për vitin 2017 e ka ngritur Kuvendin e Kosovës

si një ndër institucionet më transparente dhe më të përgjegjshme në shpenzimin e buxhetit. Ajo që bie sy në raportin e Auditorit, i cili ka bërë edhe krahasime ndër vite për mënyrën e menaxhimit të Kuvendit, vërehet se në tre vjetët e fundit, prej që Kuvendi udhëhiqet nga kryeparlamentari Kadri Veseli, është shënuar

shumë progres në rritjen e transparencës dhe menaxhimit efikas të buxhetit të Kuvendit të Kosovës. "Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin

Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren ME, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore", është thënë në Raportin e Auditorit. Sipas raportit, Kuvendi i Kosovës

ka realizuar në masën mbi 90 për qind buxhetin pa asnjë parregullsi, ndërsa është vlerësuar edhe transparenca gjatë realizimit të të gjitha pagesave sipas kategorive të buxhetit të Kuvendit. Auditori ka vlerësuar në raport se nuk ka gjetur asnjë vërejtje në menaxhimin e prokurimit publik dhe në menaxhimin e kontratave.

Ramiz Kelmendi dënohet nga AKP-ja 1 milion e 300 mijë euro

PRISHTINË, 27 QERSHOR (ER) - Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) e ka dënuar "Elkosin" me gjobë prej 1 milion e 300 mijë eurosh. Mospërmbajtja e kontratës për firmën "Famipa" nga

Prizreni ka qenë arsyeja që ka shtyrë AKP-në ta marrë këtë vendim. Vendimi është marrë në mbledhjen e bordit të drejtorëve të AKP-së. "Bordi mori vendim lidhur me ndërmarrjen e re 'Famipa'

me të cilin blerësit i janë shqiptuar ndëshkime financiare mbi 1 300 000 euro për mospërmbajtje të detyrimeve kontraktuale" është thënë në njoftimin e AKP-së. Biznesmeni Ramiz Kelmendi, i cili

aktualisht është deputet i LDK-së, në vitin 2011 ka blerë nga Agjencia Kosovare e Privatizimit fabrikën "Famipa" në Prizren, një prej ndërmarrjeve më të njohura në kohën e ish-Jugosllavisë.

Oda Ekonomike e Kosovës organizon Forumin Ekonomik në mes të Kosovës dhe Malit të Zi

Kosova dhe Mali i Zi, të gatshëm për t'i hequr barrierat ekonomike



Sekretari shtetëror në Ministrinë e Financave të Malit të Zi, Branislav Todoroviç, ka bërë me dije se të dy vendet janë të përkushtuara t'i heqin barrierat ekonomike. "Ne kemi tregje të vogla dhe gjeografikisht jemi të drejtuar nga njëri-tjetri. Kemi pasur takim me ministrin e Financave dhe kemi shprehur gatishmërinë se duhet t'i heqim barrierat mes dy vendeve", ka thënë Todoroviç.

EPOKA ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 27 QERSHOR - Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) dhe Oda Ekonomike e Malit të Zi kanë organizuar të mërkurën Forumin Ekonomik Kosovë - Mali i Zi. Në këtë forum ishin të pranishëm rreth 28 kompani malazeze të sektorëve të ndryshme, Dogana dhe Administrata Tatimore, përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës dhe të Financave të Malit të Zi, si dhe përfaqësues të agjencisë për promovim të investimeve nga ky shtet.

Nga Kosova ishin të pranishme biznese vendore si dhe përfaqësues nga institucione të ndryshme të shtetit.

Kryetari i OEK-ut, Safet Gërxhaliu, ka thënë se bashkëpunimi në mes të Odës Ekonomike të Kosovës dhe Malit të Zi duhet të jetë shembull edhe për institucionet e tjera në vend. "Këmbimi tregtar, lëvizja e qytetarëve, investimet në infrastrukturë dhe turizmi janë aktivitetet që i karakterizojnë raportet me Malin e Zi. Me Odën Ekonomike të Malit të Zi kemi bashkëpunim që duhet të jetë

shembull edhe për institucionet e tjera. Bashkëpunimi ekonomik me Malin e Zi nuk duhet të shikohet si bashkëpunim konkurrues, por së bashku duhet të gjejmë forma të bashkëpunimit që ekonominë tonë ta shtrijmë edhe në vendet e tjera. Sa i përket këmbimit tregtar, bilanci është pozitiv dhe duhet të punohet që edhe më shumë ta risim bashkëpunimin", ka thënë Gërxhaliu.

Ai ka theksuar se marrëveshja e nënshkruar në mes të Ministrisë së Infrastrukturës të Kosovës dhe asaj të Malit të Zi do të ndikojë pozitivisht në ekonominë e dy vendeve. "Marrëveshja e nënshkruar mes Ministrisë së Infrastrukturës të Kosovës dhe Malit të Zi për eliminimin e barrierave kufitare ndikon pozitivisht në ekonominë e dy vendeve. Raportet e mira politike të shndërrohen në favore të mira ekonomike", ka thënë ai.

Ivan Saveljiç, nënkryetar i Odës Ekonomike në Malin e Zi, ka pohuar se është me rëndësi që bashkëpunimi mes dy vendeve të vazhdojë. "Duhet t'i identifikojmë sfidat dhe të gjejmë zgjidhje që t'i tejkalojmë. Shtetet tona janë të

interesuar për fuqizimin e subjekteve ekonomike. Sot kemi pasur rastin që në bisedën me Ministrinë e Financave të dëgjojmë rrëfim për bashkëpunim të fuqishëm për Malin e Zi dhe Kosovën", ka thënë Seveljiç, duke shtuar se duhet të krijohen lidhje që të përmirësohet ekonomia e të dy vendeve. "Kosova është partnere ekonomike e rëndësishme për Malin e Zi. Ne mund të bashkëpunojmë në energji, turizëm dhe të tregojmë se jemi të gatshëm për bashkëpunim ekonomik", ka thënë ai.

Gazmend Abrashi, koordinator Rajonal i Zyrës së kryeministrit, ka thënë se lidhja ekonomike e dy vendeve është e rëndësishme së veçantë. "Unë e përkrahi marrëveshjen që do ta nënshkruajmë ditët e ardhshme lidhur me policat e sigurimit. Numrat tregojnë se disponimi është i mirë për bashkëpunim", ka thënë ai. Branislav Todoroviç, sekretar shtetëror në Ministrinë e Financave të Malit të Zi, ka pohuar se të dy vendet janë të përkushtuar t'i heqin barrierat ekonomike. "Ne kemi tregje të vogla dhe gjeografikisht jemi të

Nënshkruhet marrëveshja për transport ndërkombëtar të mallrave dhe njerëzve me Malin e Zi

Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka pritur të mërkurën në një takim ekipin koordinues të Malit të Zi për hartimin e Marrëveshjes Bilaterale për Transport Ndërkombëtar të Mallrave dhe Njerëzve, e udhëhequr nga zëvendësministri i Transportit dhe Çështjeve Detare, Dalibor Milosevic. Ministri Lekaj ka falënderuar anëtarët e delegacionit nga Mali i Zi, duke thënë se edhe heqja e taksës së sigurimit kufitar mes dy vendeve duhet të ndodhë, ngaqë i shërben qarkullimit të lirë. Pas takimit, udhëheqësit e dy delegacioneve, zëvendësministri Rexhep Kadriu dhe zëvendësministri Dalibor Miloseviç, kanë nënshkruar dokumentmarrëveshjen e cila i paraprinë nënshkrimin të Marrëveshjes Bilaterale për Transport Ndërkombëtar të Mallrave dhe

Njerëzve në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Malit të Zi. "Ky dokument u nënshkrua pas punës dyditore të dy grupeve koordinuese të të dy vendeve, të cilët kanë harmonizuar dokumentacionin bazë për nënshkrimin e marrëveshjes bilaterale mes dy vendeve, e që do të ndodhë gjatë muajit korrik të këtij viti, e cila ka për qëllim largimin e barrierave për Transport Ndërkombëtar të Mallrave dhe Njerëzve mes dy vendeve nënshkruese. Bashkëpunimi i të dy vendeve dëshmon edhe një herë marrëdhëniet e mira të miqësisë mes vendit tonë dhe Malit të Zi, si vende mike dhe të gatshme që njëra-tjetrën ta trajtojnë si partnere me rëndësi strategjike në rrugëtimet euroatlantike të dy vendeve tona", është bërë me dije në njoftimin e Ministrisë së Infrastrukturës.

drejtuar nga njëri-tjetri. Ne kemi pasur takim me ministrin e Financave dhe kemi shprehur

gatishmërinë se duhet t'i heqim barrierat mes dy vendeve", ka thënë Todoroviç.

Formohet Bordi i Qendrës së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në Ferizaj

FERIZAJ, 27 QERSHOR (ER)

- Me vendim të kryetarit të Komunës së Ferizajt, Agim Aliut, është formuar Bordi i Qendrës së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë. Bordi i Qendrës së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë përbëhet nga Alban Bytyqi, përfaqësues i komunitetit të biznesit, i cili është edhe kryesues ekzekutiv, Lulzim Aliu, përfaqësues nga Komuna e Ferizajt, Bujar Cakolli, përfaqësues nga Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Flamur Salihu, përfaqësues nga Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj dhe Shqipërim Lubishtani, përfaqësues nga shoqëria civile.

Bordi Ekzekutiv i Qendrës së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë



ka për detyrë ta bëjë përzgjedhjen e menaxhmentit të qendrës, t'i përgatisë referencat për kompanitë menaxhuese si dhe hartimin e planit investiv të objektit dhe të pajisjeve për funksionalizimin e Qendrës Inovative.

Kryetari i Ferizajt, Agim Aliu, ka pritur në takim anëtarët e këtij bordi, të cilëve u ka uruar punë të mbarë për jetësimin e platformës për nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe mundësisë për të rinjtë ferizajas.



FSK-ja në operacion kërkim-shpëtimi në Gurbardh të Malishevës

MALISHEVË, 27 QERSHOR (ER) - Ekipet e Kërkim-Shpëtimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës kanë filluar operacionin e kërkimit të një personi me inicialet M. B. nga fshati Gurbardh i Komunës së Malishevës.

Forca e Sigurisë së Kosovës është angazhuar në opera-

cionin e kërkimit në rajonin e Malishevës me vendim të ministrit Rustem Berisha dhe me urdhër të komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, pas kërkesës së bërë nga Kuvendi Komunal i Malishevës. Ekipit e FSK-së të Kërkim-Shpëtimit në Male, gjithsejtë 18

pjesëtarë dhe njësia K-9 (njësia manovruese me qenë të stërvitur), janë në bashkëpunim të vazhdueshëm edhe me institucione të tjera si dhe vullnetarë të shumtë. Operacioni i kërkimit është në vllugun e tij dhe se FSK-ja do t'i vazhdojë kërkimet më tutje.

Kërkohet investim për arritjen e barazisë gjinore

KAÇANIK, 27 QERSHOR (ER) - Grupi i Grave Deputete, me mbështetje të UNFPA-s, organizoi tryezë në Komunën e Kaçanikut. Komuna e Kaçanikut ka qenë nikoqire e tryezës lidhur me prezantimin e planit të punës të Grupit të Grave Deputete si dhe bashkëpunimit midis deputeteve të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe asamblistëve. Në këtë tryezë morën pjesë përfaqësueset të grupeve të grave nga komunat Ferizaj, Hani i Elezit, Shterpcë dhe Kaçanik.

Kryetari i Komunës së Kaçanikut, Besim Ilazi, ka thënë se është një nder dhe privilegj që Komuna e Kaçanikut është zgjedhur nikoqire e këtij takimi të rëndësishëm, përmes të cilit do të shkëmbehen përvojat më të mira si nga niveli qendror ashtu edhe nga ai lokal në fushën e barazisë gjinore. Kryetari Ilazi ka theksuar se deri më tani nuk ka refuzuar asnjë kërkesë apo projekt që ka qenë nga iniciativa e grave asambliste komunale.

Ndërkohë, kryetarja e Grupit të Grave Deputete, Mexhide Mjaku-Topalli, ka pohuar se edhe në këtë takim do të diskutohen temat në interes të për-bashkët, duke shtuar se nëse shoqëria investon në arritjen e barazisë gjinore, përfiton e gjithë shoqëria. Ajo ka uruar që secilit t'i jepen mundësi të barabarta për të dy gjinitë ngaqë, ky investim, sipas saj, ndikon pozitivisht në aspektin ekonomik, social, politik, duke shfrytëzuar potencialin e grave dhe të burrave.



Gashi merr pjesë në konferencën e donatorëve

KASTRIOT, 27 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Kastriotit, Xhafer Gashi, ka marrë pjesë në konferencën e organizuar nga USAID-i dhe CDF-i, në të cilën është bërë prezantimi i projekteve nga përfaqësuesit e komunave që kanë punuar gjatë kësaj kohe në takimet e tyre të planifikuar dhe të mbajtura në formën e diskutimeve dhe prioriteteve që secila komunë ka

paraparë. Në këtë konferencë në fokus ka qenë tema "Përmirësimi i shërbimeve ndaj qytetarëve në gjashtëmbëdhjetë komunat partnere të programit 'AKT LS'". Përfaqësuesit e grupit punues nga Komuna e Kastriotit i ka mbështetur edhe kryetari Gashi, i cili ka përcjellë nga afër punimet e kësaj konference, përkatësisht të këtij grupi punues.



Rahoveci cakton shtabin komunal për korrje-shirje

RAHOVEC, 27 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka nënshkruar vendimin për caktimin e shtabit komunal për korrje-shirje për vitin 2018. Sipas vendimit, kryesues është caktuar drejtori i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Berat Duraku, kurse Selami

Mashuku zëvendëskryesues, ndërsa Asllan Mazreku, Milazim Elshani dhe Njazi Sokoli janë caktuar anëtarë. Bazuar në këtë vendim, shtabi komunal ka për detyrë ta bëjë përcjelljen e korrje-shirjeve në terren në gjithë territorin e Komunës së Rahovecit gjatë tërë fushatës deri në për-

fundimin e saj. Obligimet e shtabit komunal janë që me kohë ta njoftojnë kryetarin e komunës si dhe personat e tjerë kompetentë nga sfera e bujqësisë si dhe Ministrinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillimit Rural me raport, kohë pas kohe lidhur me rrjedhën e korrje-shirjeve.

600 MIJË PYETJE



Pandeli MAJKO

Lajmet se në Shqipëri do të hapen kampe për 600 mijë refugjatë sirianë janë përtej çdo gatishmërie e imagjinatë për një prej kombeve më të vjetër të Evropës siç janë shqiptarët.

Mediet mund të japin lajme, por jo të nxisin panik në një popull që është një shembull në atë çfarë ofron për të huajt.

Nëse dikush nuk di të merret me diktatorin e Sirisë, pa dyshim se nuk kupton se ky individ dhe aleatët e tij, Rusia dhe Irani, po

përdorin refugjatët sirianë si "bombë njerëzore".

Qëllimi është për ta shkatërruar strukturën evropiane si ngrehinën kryesore ndërkombëtare e cila mbart vlerat që ata nuk i kanë.

Është një krim cinik dhe anti-njerëzor që si teknologji ka filluar me luftën e Jugosllavisë. Arma synon panikun. Qëllimi është që ta ngjallë pasionin e ADN-së për "ruajtjen e territorit" i cili nuk është njerëzor. Krijimi i "antinjeriut" vjen si ftesë nga kjo aleancë e pashpallur lindore e cila po troket në Evropën me politikanë që masin çdo gjë me vota...

Shtëpia e shqiptarit është e zotit dhe e mikut. Kështu shkruhet në rregullat e lashta të trajtimit të të huajve që trokasën në derën e shtëpisë së shqiptarit.

Shqiptarët janë populli më

miqësor me të huajt dhe që i mbron ata me vullnet e pa kërkesë nga të tjerët.

Askush dhe për asnjë arsye nuk mund ta fyejë kombin shqiptar duke luajtur me këtë ndjenjë kaq pozitive karshi të huajve.

Shqipëria është një rast i rrallë në një botë refuzuese për të huajt. Çdo familje shqiptare ka migrantë jashtë vendit, në Perëndim, dhe kjo është një arsye më shumë për të qenë dashamirës me ata që janë larguar nga vendi i tyre për arsye të mbijetesës.

Si njohës modest i krizave të tilla humanitare e vlerësoj të pavend përhapjen e lajmeve të tilla të cilat mund të shkaktojnë panik në vendin më miqësor me të huajt siç është Shqipëria. Ajo nuk është një "epruvetë" ku interesat politike dhe paaftësitë menaxhuese të të tjerëve të gje-

jnë justifikim me "eksperimente" të tilla.

Grumbullimet e refugjatëve në sasi sfiduese për vendasit do të krijojë situatë shpërthyesë për të cilën duhet të bëhen mirë llogaritë.

Shqipëria ka gatishmëri për të huajt por askush nuk mund të bëjë "humor" nisur nga nevojat e saj. Në se ka ndonjë politikan evropian i cili diskuton "ftesën" për të hapur negociatat e integritit evropian për Shqipërinë me pranimin e ndërtimit të kampeve të refugjatëve atëherë kjo "ftesë" më mirë të mos vijë... Pasi ajo nuk do të ishte ftesë, e aq më pak ftesë evropiane.

Jam i bindur, që Brukseli nuk mund t'i kërkojë një vendi dhe populli, ndryshimin e strukturës së vet sociale duke vënë në diskutim sigurinë e tij kom-

bëtare dhe më gjerë.

Të huajt që të vijnë në derën e shtëpisë për ndihmë, janë miq! Ata që ti sjellin... janë miq të refuzuar të dikujt tjetër. Ky është përkthimi që shqiptarët do të bëjnë një ftese për kampe refugjatësh në Shqipëri.

Shqipëria do të ishte e gatshme të ndajë peshën e çdo krize me familjen e vet evropiane por shqiptarët nuk janë njerëz naivë. Ata dyshimin e tyre do ta fillonin me pyetje të thjeshta...

"Pse diçka që nuk është e mirë për Evropën është e mirë për Shqipërinë?" Dhe më ironikja vjen më pas "Në se na kërkon diçka që nuk e bëni vet, a na bën kjo më evropianë apo e kundërta?"... Janë 600 mijë pyetje për një të vërtetë. Natyrisht!

(Autori është ministër i Shtetit për Diasporën në Shqipëri)

GJENOCIDI I PANDËSHKUAR GREK NË ÇAMËRI



Lulëzim ETEMAJ

Shqiptarët, kudo që të jenë, përkujtojnë këto ditë gjenocidit grek të ushtruar ndaj bashkëkombësve të tyre, banorë autoktonë të Çamërisë.

Dita e sotme na kujton një nga datat më tragjike, nga një varg datash të tilla, të ruajtura në kujtesë si akte të dhimbjes kulmore të kombit tonë. Masakra në Klogjer, e kryer më 25 qershor 1944 nga ushtria e gjeneralit famëkeq Napoleon Zerva, ku mbetën të vrarë ose vdiqën rrugës, përgjatë udhëtimit biblik në përpjekje për ta shpëtuar kokën, mbi 2 700 persona, shënon fillimin e gjenocidit grek ndaj çamëve, një nga më të rrallët dhe nga më të tmerrshmit në historinë e njerëzimit. Dy ditë më vonë, më 27 qershor 1944, po këto

forca kryen në zonën e Paramithisë një nga masakrat më të egra ndaj çamëve, ku për pasojë mbetën të vrarë rreth 600 persona, burra, gra dhe fëmijë. Masakra e Pargës, Filatit, Igumenicës, Spatarit, të kryera në vitet 1944-1945, kanë përshkallëzuar gjenocidin grek duke e ngritur, sipas statistikave të Shoqatës "Çamëria", në gjithsejtë 2 771 numrin e civilëve shqiptarë të vrarë e të masakruar, krahas rreth 2 800 të tjerëve të dëbuar dhunshëm nga shtëpitë e tyre, të cilave, pasi janë plaçkitur, u është vënë zjarri.

Ky gjenocid i ushtrisë greke provon qëndrimin e Athinës zyrtare, që përmes vrasjeve dhe dëbimeve të përmasave gjenocidale të fshijë çdo gjurmë të ekzistencës së shqiptarëve në trojet e veta etnike.

Pavarësisht asaj se a është ende në fuqi apo jo vendimi i Kuvendit të Shqipërisë, i 30 qershorit 1994, përmes së cilit 27 qershori ishte shpallur si "Dita e Përkujtimit të Gjenocidit Çam", shqiptarët, posaçërisht Tirana dhe Prishtina zyrtare, do të duhej të mos e lënë këtë ditë të kalojë në heshtje, por përmes veprimtarive të shumta, poli-

tike dhe diplomatike ta sensibilizojnë opinionin ndërkombëtar përkritazi me drejtësinë e munguar ndaj çështjes çame, përkatësisht mostrajtimin nga ana e drejtësisë ndërkombëtare të gjenocidit grek në Çamëri të kryer 74 vjet më parë, kurse përmes veprimtarive të ndryshme përkujtimore si dhe marshimeve të organizuara paqësore drejt kufirit të Greqisë, të tregohet se qëndrojnë në këmbë dhe madje ende janë të freskëta shpresa dhe vullneti për kthimin e çamëve në vendin dhe pronat e tyre stërgjyshore.

Pjesëtarët e FSK-së u japin ndihmën e parë të aksidentuarve

PRISHTINË, 27 QERSHOR (ER) - Një ekip e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), përkatësisht i Njësisë Ndërlidhëse për Reagim në Kriza përgjatë rrugës Prishtinë - Ranillug, afër Ranillugut, ofroi ndihmën e parë në vendin e aksidentit dy personave civilë të lënduar si pasojë e aksidentit rrugor si dhe janë përkujdesur për të njëjtit derisa autoambulanca dhe personalia mjekësorë i ka evakuuar për në

spital.

Ekipi i FSK-së ishte duke udhëtuar për në Komunën e Ranillugut ku FSK-ja rregullisht merr pjesë në takimet zyrtare për siguri në komunat e Kosovës.

Pjesëtarët e FSK-së janë të trajnuar për ofrimin e ndihmës së parë, edhe ndihmës së parë në vendngjarje dhe shpesh kanë intervenuar dhe kanë shpëtuar jetë njerëzish, pra në raste aksidentesh etj.



Emri i Maqedonisë, Zaevi: Jap dorëheqje nëse referendumi s'ka sukses

SHKUP, 27 QERSHOR - Kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev, ka bërë me dije se do të japë dorëheqje nëse referendumi për emrin nuk ka sukses. "Po, do të largohem nga

pozita e kryeministrit nëse nuk ka sukses referendumi. Por, jam i sigurt se do të ketë sukses", ka thënë kryeministri Zoran Zaev. Ai ka thënë se pret mbështetjen e qyte-

tarëve për emrin në këtë referendum. "Pres përqindje serioze 75-85 %, në pajtueshmëri me atë se janë deklaruar qytetarët për anëtarësim në BE dhe NATO. Qytetarët

nuk kanë çfarë të zgjedhin, nuk kanë alternativë tjetër. Ata vetëm duhet ta konfirmojnë se duan që Maqedonia të jetë anëtarësim në BE dhe NATO", ka thënë Zaev.



Wess Mitchell: Evropa, Ballkani dhe trysnitë politike

UASHINGTON, 27 QERSHOR - Ndhimëssekretari amerikan i Shtetit për Evropën, Wess Mitchell, ka bërë një pasqyrë të politikës amerikane në Evropë, duke theksuar se kontinenti është edhe një herë një teatër i konkurrencës serioze strategjike.

Në një seancë dëgjimore para një nënkomisioni të Senatit për Evropën dhe Bashkëpunimin Rajonal, diplomati amerikan ka thënë se Evropa po përballet me presione në shumë fronte si fushatat strategjike nga Rusia dhe Kina, vala rekord e imigracionit, ambicet e Iranit në Mesdhe dhe një krizë besimi në institucionet evropiane. "Ne kërkojmë një marrëdhënie më të mirë me Rusinë, por kjo mund të ndodhë vetëm kur Rusia ta ndalë sjelljen e saj agresive. Ne nuk do të bëjmë kompromis me parimet tona apo aleatët tanë. Siç tha sekretari Pompeo, vitet e politikës së butë që mundësuan agresionin rus kanë marrë fund; ne do të vazhdojmë t'ia rrisim kostot agresionit rus derisa presidenti Putin të zgjedhë një rrugë të ndryshme", ka deklaruar Mitchell.

Shtetet e Bashkuara po ndërtojnë një strategji afatgjatë për ta forcuar praninë amerikane në Mesdheun Lindor duke kultivuar Greqinë si një shtyllë stabiliteti



në Mesdhe dhe në Ballkanin Perëndimor dhe duke punuar për ta forcuar sistematikisht sigurinë dhe bashkëpunimin energjetik me Qipron. Ndhimëssekretari amerikan i Shtetit për Evropën ka pohuar

se Shtetet e Bashkuara po rrisin angazhimin e tyre në Ballkanin Perëndimor. "Përmes një diplomacie aktive dhe koordinimi të ngushtë me BE-në, ne mbështetëm udhëheqësit vizionarë, kryeministrin

Tsipras dhe kryeministrin Zaev për arritjen e një marrëveshjeje historike në ngërçin për emrin mes Maqedonisë dhe Greqisë. Ne kemi shtuar komunikimin me Serbinë dhe Kosovën dhe po promovojmë reforma në

Bosnjë-Hercegovinë", është shprehur ai.

Duke iu përgjigjur një pyetjeje të senatores Jeanne Shaheen lidhur me demonstratat e zhvilluara në Greqi dhe Maqedoni dhe mundësinë që këto zhvillime të ndikojnë negativisht në ratifikimin e marrëveshjes, ndihmëssekretari i Shtetit ka thënë se është i shqetësuar nga mundësia e një ndërhyrjeje të Rusisë, e cila u pa qartë në Malin e Zi.

Mitchell ka theksuar se përfaqësuesit rusë kanë bërë deklarata kërcënuese duke e bërë situatën shqetësuese. "Ua kemi bërë të qartë rusëve se po e monitorojmë situatën nga afër dhe se nuk i takon Moskës të vendosë për të ardhmen e Maqedonisë", ka thënë ai.

Ndhimëssekretari i Shtetit e sheh zgjidhjen e çështjes së emrit të Maqedonisë të një përmase si marrëveshja e Dejtonit që i dha fund konfliktit të viteve '90-ta në Ballkan. Ai ka thënë se efektet e suksesit të marrëveshjes në mes të Greqisë dhe Maqedonisë do të shërbejnë si një mundësi e mirë për ta vazhduar zgjidhjen e problemeve të tjera në Ballkan, si dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe gjendja në Bosnje-Hercegovinë. (VOA)

Shtetet amerikane hedhin në gjyq administratën e Trumpit

UASHINGTON, 27 QERSHOR - Shtatëmbëdhjetë shtete amerikane kanë paditur administratën e presidentit të Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, për, siç është thënë, ndarjen e familjeve të migrantëve në mënyrë "mizore dhe të paligjshme". Prokurorët e përgjithshëm demokratikë nga disa vende, duke përfshirë, Uashingtonin, Nju Jorkun dhe Kaliforninë, kanë

prezantuar veprimin ligjor. Në padi kundërshtohet politika e refuzimit të hyrjes për azilkërkuesit në kufirin ShBA - Meksikë. Në po të njëjtën kohë, një gjykatë në Kaliforni ka marrë vendim që të gjitha familjet e migrantëve të ndara në kufirin amerikan duhet të bashkohen brenda 30 ditëve. Gjyqtari në San Diego, Dana Sabraw, po ashtu ka thënë se fëmijët nën moshën pesëvjeçare duhet

të kthehen te prindërit e tyre brenda 14 ditëve. Javën e kaluar presidenti Trump ka bërë thirrje për dëbim të migrantëve, vetëm disa ditë pasi ka nënshkruar urdhrin ekzekutiv për t'i mbajtur familjet të bashkuara. Këto vende tani po kërkojnë nga gjykata një urdher që do t'i bashkonte familjet dhe do ta ndalonte praktikën e ndarjes, duke e cilësuar këtë veprim, "në kundërshtim me Kushtetutën".

firmat private të sigurisë në gjithë botën janë duke i monitoruar me kujdes kërcënimet në Ukrainë, pasi ky vend ka qenë origjinë e disa prej sulmeve më serioze kibernetike që kanë ndodhur në botë.

Ukraina thotë se Rusia po përgatit sulm të madh kibernetik

KIEV, 27 QERSHOR - Kreu i policisë kibernetike të Ukrainës, Serhiy Demedyuk, ka thënë se hakerët rusë po piraterojnë sistemet kompjuterike të kompanive të Ukrainës për t'i hapur rrugë "një sulmi të koordinuar, të shkallës së

gjerë". Demedyuk i ka thënë agjencisë "Reuters" se bankat dhe kompanitë energjetike janë në mesin e shënjestrave të hakerëve të dyshuar dhe tha se policia e Ukrainës është duke punuar me

autoritetet e huaja për t'i identifikuar fajtorët. Zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, i hodhi poshtë pretendimet e Demedyukut, duke i cilësuar "të pavërteta". Autoritetet e sundimit të ligjit dhe

firmat private të sigurisë në gjithë botën janë duke i monitoruar me kujdes kërcënimet në Ukrainë, pasi ky vend ka qenë origjinë e disa prej sulmeve më serioze kibernetike që kanë ndodhur në botë.



Hapërimi i kujdestarit të privatësisë



Jeton ARIFI

Dita e fundit e qershorit nuk simbolizon, thjesht, një datë të zakonshme kalendarike për Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, apo për shoqërinë e shtetit tonë të ri. Shtatë vjet më parë u vunë themelet e institucionit, në dyert e të cilit mund të trokasë çdokush që pretendon se të dhënat personale po i keqpërdoren.

Mora shkas nga plotësimi i ciklit shtatëvjeçar të ekzistencës së këtij institucioni për ta bërë këtë shkrim dedikuar qytetarit skeptik, atij që beson në të drejtën e pacenueshme në privatësi, ndërmarrësve që përpunojnë të dhënat tona në sajë të gjenerimit të kapitalit të tyre, si dhe atyre që me fjalën apo/dhe votën e tyre vendosin për fuqinë që duan t'i japin këtij autoriteti. Ky adresim nuk është vetëm si zëvendësim i një organizimi tradicional, me të ftuar e fjalime, por edhe për të ndarë me publikun se çfarë po ndodhë me 'kujdestarin e privatësisë', të cilin, mbase, disa prej jush, para se ta lexonit këtë shkrim, nuk e dinit që ekzistonte, si institucion i mandatuar nga shteti që t'ju shërbejë juve.

Kjo datë që simbolizon gjysmën ndarëse të vitit, lidhet me përvjetorin e themelimit të autoritetit të vetëm që punon për ta mbrojtur privatësinë e qytetarëve, e shumë shpejt, edhe për t'u garantuar atyre të drejtën për të qenë të informuar.

Nëse besohet se, në praktikë, privatësia i bënë gjërat (e mira) të zgjasin më shumë, atëherë mund të konkludohet se informimi i bënë njerëzit të ndihen më të sigurt. Mbështetja e jetësimi të këtyre dy të drejtave nga një autoritet i vetëm, jo që është praktikë e dëshmuar si e suksesshme në rajon e më gjerë nëpër Evropë, por ngërthen brenda vetes racionalitetin e ndarjes proporcionale të

burimeve njerëzore e financiare, në kuptim të lehtësimi të barrës për buxhetin e shtetit.

Është e qartë se jemi në kohë ndryshimesh, jo vetëm ne, si autoritet, por edhe si shoqëri e digjitalizuar. Hyrja në fuqi e GDPR-së, zhvillimi i shpejtë i teknologjisë, roli i pamohueshëm që po luajnë të dhënat në jetën moderne janë elemente që po i prijnë evolucionit.

Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave sjell një qasje që i përket shekullit të ri. E drejta e konsumatorëve për të transferuar të dhënat është krejtësisht e re, siç është detyrues edhe raportimi për shkeljet ndaj të dhënave, pastaj standardet më të larta për marrjen e pëlqimit, duke mos lënë pa theksuar gjohet e rritura në rastet kur kompanitë nuk i zbatojnë këto të drejta.

Ndryshimi i madh, në sajë të ndryshimeve ligjore që po ndodhin, ka të bëjë me lënien e kontrollit në duart e konsumatorëve ndaj të dhënave të tyre. Ky gjithësesi që është zhvillim pozitiv. Subjektet e të dhënave e kuptojnë se me raste duhen t'i ndajnë të dhënat e tyre personale për t'i marrë shërbimet më të mira nga kompanitë.

Secili prej nesh që jemi të angazhuar në fushën e të drejtës në privatësi, në baza ditore, përpigjet ta bëjë ndryshimin për publikun.

Si kolektiv, them se po bëjmë punë të mirë. Adresimet e shpesh të qytetarëve tanë në Agjenci më bëjnë të besoj se njerëzit këtu nuk kanë qenë ndonjëherë më të vetëdijshur rreth të drejtave të tyre në këtë segment, se çfarë mund të presin nga bizneset dhe organizatat, të cilëve ata ua besojnë të dhënat e tyre. Në këtë aspekt nuk kemi kohë për të humbur.

Kemi shumë për të bërë, ne, si autoritet i mandatuar për ta mbikëqyrur jetësimin e këtyre të drejtave, duke vepruar bashkë me kontrolluesit e të dhënave nga sektori publik dhe privat, për të qenë në gjendje t'i kundërpërgjigjeni botës që po ndryshon me hapa të shpejtë.

Përsheptimi i kësaj pritë të bëhet nga Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së

Sigurisë, në Kuvendin e Republikës së Kosovës i cili ditë më parë bëri hapat e parë pozitivë, duke ngritur një komision të posaçëm rreth shqyrtimit të projektligjit të ri për mbrojtjen e të dhënave personale.

Ndryshimet në Agjenci

Agjencia, si autoritet mbikëqyrës, nuk do të mbetet pa ndryshuar. Edhe ajo do të evoluojë, duke shtuar numrin e punonjësve, duke ofruar shërbimet më të mira të mundshme për qytetarët, duke vazhduar edukimin e ndërgjegjësimin e kontrolluesve dhe vetëdijësimin e subjekteve të të dhënave (qytetarët).

Aprovimi i këtij projektligji, pa zvarritje, fuqizon institucionin që mbikëqyrë zbatimin e këtij ligji, e derivativisht e bën qytetarin të ndihet më i mbrojtur. Dispozitat e reja të tij, që kryesisht rrjedhin nga kriteret e GDPR-së (që, si institucione, në janarin e vitit të kaluar i kishim marrë obligim për t'i transpozuar, veç të tjerash, i japin një mandat shtesë kësaj agjencie, atë për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Qasje në Dokumente dhe Informacione Publike. Më në fund, mbikëqyrja e zbatimit të së drejtës për informim po bëhet nga një autoritet me mandat të qartë. Ky është një lajm i mirë për qytetarët e republikës sonë, ndonëse një e drejtë e këtille në Suedi ishte rrënjësore 250 vjet më parë.

Për ata që deri dje e kishin të vështirë ta mbanin mend emrin e gjatë të këtij autoriteti, lajmi i mirë është se pas aprovimit të këtij projektligji ai do të jetë më i shkurtër: 'Agjencia për Informim dhe Privatësi'. Ndërkaq, për ata kontrollues të të dhënave, të cilët nuk i përmbyshnin me kohë rekomandimet, e njëjta do të shqiptojë drejtpërdrejt gjoha edhe më të larta ndaj shkelësve të papërgjegjshëm të kësaj të drejte qytetare, që deri dje duhej ngritur padi në gjykatë dhe të pritej me shpresë që lënda të mos parashkruhej si pasojë e numrit enorm të lëndëve që vazhdojnë t'i mbingarkojnë shtetit e gjykatave.

Sidoqoftë, këto dispozita nuk

duhen kuptuar si frikësuese për përpunuesit e mëdhenj të të dhënave, kryesisht në sektorin privat, sepse ata që ende nuk e kanë të caktuar një zyrat për mbrojtjen e të dhënave brenda kolektivit të tyre, le ta fillojnë rekrutimin sepse kjo pozitë, e ushtruar nga një zyrat i përgjegjshëm, do t'i shpëtojë ata nga gjohat eventuale.

Modeli i përzgjedhur shtatë vjet më parë për të udhëhequr këtë institucion nga një organ kolegial, gjatë pesëvjetëshit të parë të funksionimit të kësaj agjencie, nuk u dëshmuar aq i suksesshëm. Një model të tillë, të vjetruar, në Evropë vazhdon ta ketë vetëm autoriteti homolog në Bullgari e Mal të Zi. Asnjë tjetër.

Qershia mbi tortë e këtyre ndryshimeve ligjore do të jetë pikërisht pozita e titullarit të këtij institucioni, i cili do të quhet komisionar. Fundja, në demokraci, përgjegjësia është individuale, jokolektive. Një performancë e suksesshme apo një mandat me dështime, duhet ta kenë një adresë të vetme, e 'shpërblimi' për cilindo variant t'i takojë të parit dhe të vetmit që e udhëheq atë, i cili nuk do të ketë më mundësinë e fshehjes prapa anëtarëve të tjerë të një organi kolegial.

Pak fjalë rreth GDPR-së

Kërkesat e GDPR-së aplikohen nga secili shtet anëtar i BE-së, me synimin e krijimit të një mbrojtjeje më të qëndrueshme të të dhënave personale dhe të konsumatorëve nëpër hapësirën e Bashkimit Evropian. Qëllimi i GDPR-së është që ta mbrojë privatësinë dhe shkeljet e të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale në një kohë kur përpunimi i të dhënave, në kuadër të zhvillimeve teknologjike, është shumëfishuar nga koha në të cilën është nxjerrë Direktiva e vitit 1995.

Disa nga kërkesat kryesore për privatësi dhe mbrojtje të të dhënave të GDPR-së përfshijnë:

- Forcimin e kriteve për marrjen e pëlqimit paraprak për përpunimin e të dhënave të fëmijëve;
- Marrjen e pëlqimit të subjektivit

të të dhënave për përpunimin e të dhënave;

• Pseudonimizimin e të dhënave të grumbulluara për ta mbrojtur privatësinë;

• Njoftimin rreth shkeljes së të dhënave;

• Trajtimin e sigurt të transferimit të të dhënave përtej kufijve;

• Kërkesën për disa kompani që të caktojnë një zyrat për mbrojtjen e të dhënave që ta mbikëqyrë pajtueshmërinë me GDPR-në;

Thënë shkurt, GDPR ofron një bazë autorizimesh veprimi të standardizuara për kompanitë që përpunojnë të dhënat e qytetarëve të BE-së për ta ruajtur më mirë përpunimin dhe bartjen e të dhënave personale të qytetarëve.

Në vend të përmbylljes

Jemi të vetëdijshëm që viti 2019 do të jetë shumë i ngarkuar për ne. Të punësuarit ekzistues në Agjenci dhe ata që do të bëhen pjesë e saj gjatë vitit të ardhshëm, do ta mirëpresin ngarkesën e pritit, sepse do të kenë mekanizmat e duhur për të vepruar sigurt dhe përgjegjshëm.

Objektiv thelbësor i këtij institucioni mbetet ndërtimi i një kulture të besimit të të dhënave të sigurta në Kosovë. Ne do ta bëjmë pjesën tonë, duke këshilluar, edukuar, inspektuar e zbatuar. Sidoqoftë, këtë nuk e bëjmë dot të vetëm. Mbrojtja e të dhënave përfaqëson mision, jetësimi i të cilit kërkon punë ekipore. Rregullimi efektiv kërkon angazhim me sektorin publik, atë privat, shoqërinë civile dhe qytetarët në përgjithësi.

E gjithë kjo ka të bëjë me qytetarët dhe rritjen e besimit të publikut rreth mënyrës se si po përpunohen të dhënat e tyre. Nëse ia dalim t'i aplikojmë parimet që burojnë nga ligji, mund të arrijmë ta ndërtojmë besimin te qytetarët sepse të dhënat e tyre janë të një rëndësie të veçantë për ta.

(Autori është drejtor në Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale)

'Agimi' dhe 'Rugova', me status të merituar ligjor

PRISHTINË, 27 QERSHOR (ER) - Shoqëria Kulturore-Artistike "Agimi" nga Prizreni dhe Ansambli Folklorik Autokton "Rugova" nga Peja do të kenë status të merituar ligjor. ShKA "Agimi" dhe AFA "Rugova" do të kenë status të veçantë në kuadër të Ligjit Nr. 04/L-164 për Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve "Shota" dhe ansamblet e tjera. "Kjo iniciativë është në kuadër të prior-

iteteve të mia si ministër për avancimin e kornizës ligjore. Në MKRS veçse kemi filluar të angazhohim një grup punues për koncept dokumentin që si procedurë do të jetë hapi i parë për plotësim-ndryshimin e Ligjit. Në këtë grup do të jenë anëtarë edhe nga një përfaqësues i këtyre dy shoqërive kulturore", ka thënë ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, duke shtuar se e

tëra kjo vjen duke pasur parasysh kohën e gjatë të veprimit që nga themelimi i tyre e deri më tani. "Si njëra edhe tjetra kanë mbi shtatë dekada veprimtari e aktivitet artistik, i cili ka ruajtur, kultivuar e promovuar vlerat, traditën, veshjet e karakteristikat tona kulturore duke e pasuruar në vijimësi kulturën tonë në përgjithësi dhe duke përcjellë vlerat nga njëri brez tek tjetri", ka thënë Gashi.



E jashtëzakonshme

Njeriu që shkeli në hënë padit fëmijët e vet

Astronauti amerikan Buzz Aldrin ka paditur dy fëmijët e vet dhe ish-menaxherin e tij të biznesit, duke i akuzuar se i kanë vjedhur para dhe po i dëmtojnë imazhin. Fëmijët e tij nënshkruan një peticion për marrjen e kontrollit të financave të prindit. Pjesëtarët e familjes së tij i kanë thënë gjykatësit se ai ka nevojë për një



kujdestar ligjor sepse gjendja e tij mendore tani nuk është e mirë. 88-vjeçari është njeriu i dytë që ka shkëlur në sipërfaqen e hënës.

BARSOLETA E DITËS



Një djalë i afrohet një vajze në bibliotekë dhe e shikon, vajza reagon:
 - Mos më shiko ashtu dashurueshëm, se zemra ime i takon dikujt tjetër.
 - Ti ke edhe gjymtyrë të tjera.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit në ora 15:00

“AVENGERS: Infinity War” 3D,

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 29 min

Rolet: Robert Downey Jr., Chris Hemsworth, Mark Ruffalo, Chris Evans, Scarlett Johansson, Tom Holland, Zoe Saldana, Josh Brolin, Chris Pratt, etj.

Regjia: Anthony Russo, Joe Russo



FOTO E DITES



Një vajzë e zhvendosur mëson alfabetet dhe numrat në një shkollë të improvizuar në kampin e IDP të Badbado në Mogadishu të Somalisë. /AFP/

Në ora 18:00

“ISLE OF DOGS”

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

Rolet: F. Murray Abraham, Bryan Cranston, Greta Gerwig, Jeff Goldblum, Akira Ito, Scarlett Johansson, Harvey Keitel, Frances McDormand, Bill Murray, Yoko Ono, Liev Schreiber, Fisher Stevens, Tilda Swinton, etj.

Regjia: Wes Anderson



Në ora 16:00 dhe 20:00

“DEADPOOL 2” (R)

Aksion/Aventurë/Komedi; 1 ore 59 min

Rolet: Ryan Reynolds, Josh Brolin, Morena Baccarin, Julian Dennison, Zazie Beetz, T.J. Miller, Brianna Hildebrand, Jack Kesly, etj.

Regjia: David Leitch

Gjate vikendit 19 dhe 20 maj, “DEADPOOL 2” do të shfaqet ne ora 13:00 dhe 20:00.




E rrallë

Gjyshja 102-vjeçare feston ditëlindjen plot adrenalinë

Një pensioniste guximtare, që ka lindur gjatë Luftës së Parë Botërore, ka veshur pajisjet e nevojshme dhe vendosi në kokë një helmë të përpara se të hidhej në ajër në një tunel me erë. Gjyshja 102-vjeçare, me emrin Lewis,



ndjeu forcën e erërave me shpejtësi 177 km në orë dhe nuk mund ta largonte buzëqeshjen nga fytyra e saj përgjatë gjithë kohës.



Në ora 22:00

“I FEEL PRETTY”

Komedi; 1 orë 50 min

Rolet: Amy Schumer, Michelle Williams, Rory Scovel, Emily Ratajkowski, Aidy Bryant, Busy Phillips, Tom Hopper with Naomi Campbell, Lauren Hutton, etj.

Regjia: Abby Kohn & Marc Silverstein

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).

 <p>DASHI Ditë e komplikuar pa asnjë vend të caktuar. Edhe pse do të doni të jeni të shoqërueshëm, sot nuk do të mund të toleroni shumë gjëra.</p>	 <p>DEMI Yjet ju premtojnë shumë gjëra të reja të cilat do të ishin shumë domethënëse për të ardhmen tuaj. Mund të jetë një moment shumë i mirë për të udhëtuar jashtë vendit.</p>	 <p>BINJAKËT Mos u nervozoni dhe mos u nxitoni për të dalë nga situata për shkak të disa të papriturave.</p>	 <p>GAFORRJA Sot duhet të merreni patjetër me një problem tuajin personal, përpara se të dalin persona të tjerë që marrin vendime për ju.</p>	 <p>LUANI Do të arrini t'ia dilni mban në një çështje që lidhet edhe me një person tjetër. Nëse jeni të dashuruar, mos harroni se keni një partner.</p>	 <p>VIRGJËRESHA Ju nuk jeni të vendosur në gjërat që bëni dhe kjo shkakton pasiguri edhe tek personat e tjerë pranë jush.</p>
 <p>PESHORJA Sot nuk mund ta evitoni ndihmën që duhet t'i jepni një mikut tuaj të afërt. Ai ka vërtet nevojë për ju.</p>	 <p>AKREPI Nuk ka asgjë të ekzagjeruar në sjelljen tuaj. Vetëm se personat që nuk ju njohin mirë nuk mund t'ju kuptojnë.</p>	 <p>SHIGJETARI Keni kuptuar që pozita kohën e fundit ju ka afruar me persona që kanë thjesht interes të rrinë me ju.</p>	 <p>BRICJAPI Në drejtimin që keni zgjedhur, do të keni shumë pengesa. E rëndësishme është që ju e dini mirë rrugën tuaj.</p>	 <p>UJORI Sot keni kohë për t'u marrë me punët tuaja falë suportit të madh që po ju jep një person.</p>	 <p>PESHQIT Kurioziteti i tepërt sot mund t'ju lë peng të disa situatave që nuk janë fare produktive për ju.</p>

Rita Ora i bashkohet kampanjës së "Adidas"-it



Këngëtarja e famshme me prejardhje nga Kosova, Rita Ora, i është bashkuar një kampanje të kompanisë së veshmbathjeve "Adidas", e cila po dhuron atlete për të pastrehët e komunitetit LGBTI. Së bashku me David Beckhamin dhe

Naomi Cambellin, Rita Ora ka thënë se mendon se njerëzit duhet ta kenë lirinë për të dashuruar. "Përbërësit e mi për botën e përkryer janë diversiteti dhe liria për t'u dashuruar me këdo që ndihesh mirë", ka thënë Rita.

Sekreti i çuditshëm i martesës së Nicole Kidmanit dhe Keith Urbanit



Ata janë një nga çiftet më të njohur dhe të suksesshëm të Hollivudit, kurse së fundmi festuan 12-vjetorin e martesës. Aktorja e njohur Nicole Kidman ka treguar sekretin e martesës së saj të lumtur, duke e ndjekur një rregull

të thjeshtë me bashkëshortin Keith Urban. "Ne asnjëherë nuk shkëmbejmë mesazhe sepse ndiej se kur flet me mesazhe, shumë herë mund të keqinterpretohesh", ka thënë ylli i 'Moulin Rouge!' për revistën "Parade".



Dua Lipa ka probleme me shëndetin, anulon një koncert

Këngëtarja me origjinë nga Kosova dhe me famë botërore, Dua Lipa, është sëmurë. Asaj i është dashur ta anulojë koncertin e paraparë të mbahet në Denver. Dua ka treguar se po vuan nga një infeksion në vesh,

prandaj s'ka mundur ta mbajë koncertin. Këngëtarja ka bërë një postim në llogarinë e vet në "Twitter" me anë të të cilit u kërkuar falje të gjithëve dhe ka treguar se po punon për riorganizimin e koncertit për një datë tjetër.

20-vjeçari që s'u puth kurrë nga një femër, ndez 'America's Got Talent'



Joseph O'Brien dha një performancë të shkëlqyer në sezonin e fundit të 'America's Got Talent'. 20-vjeçari fitoi zemrat e gjyqtarëve dhe publikut me këngën e Lionel Richie

'Hello'. Para performancës, Joseph ka treguar se ai kurrë nuk ka qenë në një marrëdhënie dhe se kurrë nuk është puthur. "Nuk kam të dashur. Jam beqar", ka thënë O'Brien.

Çamados, Kondurioti, Miauli, Kriezi

Nga Luan RAMA

Kur shfletoja librin e piktorit Louis Dupré mbi udhëtimin e tij nëpër Shqipëri, Greqi e deri në Stamboll, mbi takimin me Ali Pashën, suljetët që kishin mbetur në Korfuz nga "Regjimenti i Shqiptarëve", veç shumë figurave të mrekulluara, pikturuar me një mjeshtri të veçantë ishte dhe një figurë simpatike, veshur në blu, që qëndronte buzë detit, në bregun e qytetit. Një portret i bukur, që shpesh kisha menduar se ishte figura e një greku, por kisha gabuar. Ishte një arvanitas i Hidrës, i familjes së famshme Çamados që aq shumë i kishte dhënë revolucionit grek për pavarësi. Në një shënim të vogël, në fund të faqes, Dupré kishte shkruar se ai ishte biri i Anastas Çamados. Duhet thënë se hidriotët dhe speciotët, ishin banorët arvanitas që në shekullin e XV siç dokumentohet dhe nga historianët grekë, arvanitas që kishin populluar këto ishuj të shkretët e gjithë shkëmbinj, për t'u fshehur nga ndëshkimet turke apo dhe të Ali Pashës, qoftë ata që kishin ardhur nga Epiri e Çamëria, si dhe nga Eubea, apo Evia siç quhet sot. E vetmja mënyrë e ekzistencës së tyre ishte t'i drejtoheshin detit dhe të përballeshin me furtunat detare, të bëheshin marinarë të shkëlqyer dhe të ngrinin një nga flotat tregtare që do të spikaste në Mesdhe dhe që i çonte anijet e saj deri në portet e Atlantikut apo në Detin e Zi. Pikërisht atëherë u ngritën ndërtesat e tyre të mëdha të stilit venecian dhe ata nuk veshën fustanellat e

arvanitasve të tjerë, por u veshën me rroba qytetare dhe mëndafshe nga më të bukurat e botës. Ja pse kjo veshje më kishte gabuar kur kisha parë atë portret hidrioti në akuarelin e piktorit francez Louis Dupré.

Familja Çamados, siç shkruajnë historianët grekë, vinte nga Epiri, Çamëria, çka spikat që në emrin e kësaj familje: Çamado-Çamados-Çami. Ai djalos, që pozonte para piktorit francez, në vitin 1819, nuk e dinte se gjashtë vjet më vonë, në betejën e famshme të Navarinut me flotën turko-egjiptiane, babai i tij, heroi i revolucionit grek dhe admiralit Anastas Çamados, do të vritej heroikisht siç shkruhet dhe në librin "Historia e Greqisë nga viti 1892 deri në vitin 1844", nga Antoine de baron Juchereau de Saint Denys, Çamados kishte rënë bashkë me nën-admiralin e tij, heroin tjetër të revolucionit, Shahini, një tjetër çam i ardhur nga Epiri. Piktura e Dupré-së, në një format 40x50cm, na paraqet një djalos të paqetë, të bukur, me një vështrim ëndërrues buzë detit, në një kohë kur ende s'kishte filluar lufta për pavarësinë, por dhe ai, do t'i përgjigjej zërit të luftës për çlirimin e Greqisë.

Shumë udhëtarë perëndimorë kaluan nga Hidra e Specaj në shekullin e XVIII e XIX, historianë, gjeografë, arkeologë, shkrimtarë e piktorë, të cilët na lanë mjaft vepra të botuara, apo tablo që u shfaqën në ekspozitat e metropoleve europiane. Veç tablove të piktorëve grekë për figurat arvanitase, edhe piktori francez Curzon na ka lënë një

adoleshent hidriot mjaft simpatik, e po kështu dhe portretet t'famshme që ka realizuar në Specaj piktori Adam Friedel, veçanërisht e portretin e Bubulinës apo heronjve të tjerë të revolucionit të këtij qyteti. Ja pse Bubulina shkëlqen me ato kostume të mrekullueshme, aq sa duket e idealizuar nga skocezi Friedel. Kostume të veçanta, rite shqiptare, gjuhë shqipe, madje dhe kulti i gjakut, hakmarrjes kur familja ç'nderohej... Ja pse u vra dhe Bubulina, gjatë asaj hakmarrjeje kur djali i saj rrëmbeu një vajzë arvanitase të Specaj, fqinjëve të tyre.

Udhëtimi im i parë në Hidra apo Hidra siç shqiptohet në greqisht, ka qenë i paharruar, pasi gjithçka ishte poetike: deti i kaltër, qielli i pastër, një fllad që frynte në anije dhe shfaqja e magjishme e atij ishulli të vogël ku disa kulla të larta ngjiteshin ende drejt majës së malit. Ishte Hidra për të cilën kisha dëgjuar shumë. Hidra e bardhë... Gurë, deti i kaltër e i pafund, diell, histori dhe arvanitas. Hidra e bukur dhe avangarda e Revolucionit grek. Hidra, "Flota e Lirisë", atdhe i Konduriotit, Miaulit, Tombazëve dhe e admiralëve Kriezi, djepi që përkundi femijërinë dhe rininë e Bubulinës. Hidra e poetit të famshëm të shekullit XIX Jean Moreas, apo Jani nga Morea (Papadiamanti) që dhe nga nëna e i ati, siç shkruante për të poeti i famshëm francez Guillaume Apollinaire, ai ishte arvanitas që në fundin e shekullit XIX krijonte në Francë shkollën artistike të Simbolizmit francez. Përhëndesja njerëz, takoja grekë, arvanitas, shqiptarë, kapërceja shkallë të gurta dhe në çdo pëllëmbë është e pamundur të mos pikëtoke historinë me germë të madhe, "H", pasi ngado ishin gjurmët e një kohe të lavdishme.

Ishin ndërtesa të rënda të arkondëve të mëdhenj arvanitas që në rast lufte mund të ktheheshin dhe në fortesa mbrojtëse, shtëpi të thjeshta popullore zbuluar me lule, kafenetë në breg, pijetore dhe njerëz të rrahur nga deti si detarë të sprovuar që ishin të tillë historikisht në të gjithë Greqinë e Mesdheun. Hidra, vend i poetëve e artistëve, ku në një nga shtëpitë e Tombazëve sot është ngritur shkolla e Arteve të Bukura dhe ku një ditë erdhi dhe Marc Chagall. Në një ndërtesë tjetër vinte të banonte këtu Leonard Cohen (dhe më pas i biri, Adam Cohen gjithashtu që regjistroi dhe një disk të famshëm), apo ku vinte dikur Sofia Loren të luante në filmin "Hijet e detit" ... Ja, atje në sheshin e manastirit "Kimisis Teotoki", ajo kalonte duke lënë



pas imazhin e vetë bukurisë ideale. Sot, as Cohen dhe as Loren nuk janë më aty... Në kafenenë buzë bregut dëgjojmë veçse këngën e Cohen.

4.1.2


Në vitin 2004, ishte hera e tretë që shkëlqoi në Hidra, në qytezën e atij ishulli të përmbitur nga dielli ku nuk kishte makina, por veç gomerë për të udhëtuar. Ngjisja rrugicat e ngushta që më kujtonin Beratin e Gjirokastrën, kaloja krah shtëpish dhe pyesja veten se ku mund të ishte shtëpia e dikurshme e Bubulinës (Laskarinës), para se vajzë e re, ajo të shkonte nuse në ishullin fqinj Specia, nga ku s'do të kthehej më. Gjithë rinia e saj kaloi në atë liman, ku vajzat prisnin të vinin djemtë hidriotë nga peshkimi apo luftërat e gjata, nga anijet që ngranjëherë për të bërë tregti, merrnin udhën deri në Argentinë, siç e përshkruan dhe historiani e shkrimtari francez Michel de Grece, në librin "Bouboulina", të cilin e përktheva me aq dashuri. Ishte ai libër që më solli në Hidra për herë të parë në vitin 1996, ndërsa tani ishte vetë historia. Në çdo vend që shkoje, dikush mund të të fliste për shkrimtarin e poetin anglez Lawrence Durrell që vinte këtu; për mikun e tij Henry Miller e shumë të tjerë, si dhe për mikun tim Lacarriere, i cili Hidrën nuk e ndante nga goja kur bisedonim për Greqinë. Po të ecje më tutje në këmbë, të ngjiteshe sipër shpatit që binte thikë mbi det, do të gjeje lagjen e peshkatarëve apo atë që quhet "Kamino", ku në tarracën e një restoranti të vogël popullor, mund të shijoje bukurinë e botës, duke pirë një uzo me "sardelica". Më tutje, në Mandraki, në kthinat e ishullit, ishin ende gjurmët e kantierit të

vjetër detar, kur në shekullin XVIII-XIX ndërtoheshin anijet e mëdha të tregtisë e të luftës. Vetëm në kohën e Revolucionit, Hidra numëronte 125 anije dhe dhjetë mijë marinarë të saj...

Sot, sa zbret në portin e vogël të Hidrës, në të majtë, ngrihet ndërtesa e muzeut, një nga ndërtesat që Konduriotët ia falën qytetit. Që andej i dallon akoma më mirë shtëpitë hijerënda të luftëtarëve të mëdhenj me ato mure të lartë si të Konduriotëve, Miaulëve, Tombazëve... Por kur hyn në sallonet e muzeut, hyn vërtetë në histori, se aty janë portretet e arvanitasve të mëdhenj që i dhanë fitoren revolucionit grek dhe që aq shumë luftuan për lirinë. Ja portretet e admiralit Anastas Kriezi (Kryeziu), një nga detarët e lavdishëm që shkoi deri në portin e Aleksandrisë të digjte armatën e vezirit të Egjiptit. Në kohën e mbretit gjerman Oton të vendosur nga Fuqitë e Mëdha, ai ishte ministër i Marinës dhe më pas kryeministër, ashtu siç kishte qenë dhe Dhimitër Vulgaris, dikur guvernatori i qytetit e më pas tri herë kryeministër i Greqisë së re. Pak hapa më tutje, ja dhe portreti në ngjyra i Jorgo Konduriotis, i cili i dha Revolucionit dy milionë franga ari; më tutje portretet e dy admiralëve të famshëm Tombazi, Emanuel dhe Jacob Tombazi, njëri prej tyre gjyshi i poetit Jean Moreas. Krah tyre dhe një violinë "Stradivarius" e kësaj familje që ruhet ende në muze. Por ajo çka ishte më interesante ishin dy portretet e familjes Kriezi: Eleni Kriezi dhe Epaminonda Kriezi si dhe e admiralit Anastas Camidos (Çami) që të tre çamë ortodoksë të ikur nga Çamëria dhe të vendosur në Hidra. Eleni mbante atëherë paratë e Revolucionit,



dhe arvanitët heroikë të Greqisë



ashtu si dhe Maria, nëna e Anastas Camidhes. Anastasi, ishte kapiteni i anijes së famshme "Nereus", me 16 topa, që në betejën e ishullit Sfakteries më 1825 kundër anijeve egjiptiane të Ibrahim Pashës, ra heroikisht dhe hyri në legjendë, duke luftuar si dhe miku i tij Kanaris. Bashkë me Anastasin kishte rënë dhe kapiteni tjetër Stavro Shahini, një tjetër arvanitas i famshëm, fotografia e të cilit ndodhej gjithashtu në muze...

Më 1825, pas vrasjes së tij, hidriotët menjëherë i ngritën këngë, të cilën e botoi më pas më 1860, konti francez Marcellus në librin e tij Këngë popullore të Greqisë moderne. Ja ç'thotë kënga:

"Po të isha zog do të fluturoja e do të shkoja në Misolongj, të shikoja sesi vërtitet shpata, si shkrehet pushka dhe si vriten skifterët e padukshëm të Rumelisë. Ja ku një zog me krahë ngjyrë ari më thotë:

– Ndalo ti Jorgaqi; 1 nëse ke etje për gjak arabi, këtu ka turq sa të duash që mund t'i vrasësh.

– A nuk i sheh që larg anijet osmane? Vdekja nderet mbi ata që shpejt do të kthehen në pluhur.

– Zogu im i vogël, nga i di gjithë këto që thua?


– Unë të dukem si zog, por nuk jam i tillë. Unë jam Çamado, dhe nga këta qiej ku banoj tani, kam ardhur tu shpalos të ardhmen". Edhe irlandezi James Emerson, autori i librit Tablo e Greqisë në vitin 1825, kishte përshkruar mbresat e tij kur kishte zbarkuar në Hidra, duke kujtuar takimet me banorët dhe njerëzit e shquar të këtij ishulli heroik. "Ndryshe nga pjesa tjetër e Greqisë, fytyrat e grave këtu janë

më të bukura, por shamia që hedhin në kokë dhe e lidhin poshtë mjekrës ua mbulon disi këtë bukuri...". Ai shkon të takojë një nga drejtuesit apo primatët apo prijësit më të rinj të ishullit, Gjika Gjuni (ndoshta Gjoni, L.R.). "Takimet e shpeshta me europianët e kanë bërë këtë njeri me mjaft kortezi e mirësjellje. Ai ka principe të shkëlqyera dhe një gjykim të shëndoshë, çka e kanë bërë një nga njerëzit më interesantë të ishullit... ai na flet për bursat për fëmijët që ata të shkojnë në shkollë dhe të mësojnë greqishten, pasi gjuha e vendit këtu është shqipja...". Një ditë më pas ata vizitojnë në shtëpinë e tij të famshmin Kriezzi, një nga drejtuesit e vjetër të ishullit. "Ai është pothuaj tek të tetëdhjetat dhe gjyshi i tij ka qenë ndër kolonët e hershëm të Hidrës, pra ka shumë eksperiencë dhe di shumë nga historia. Ka shtatë djem, të cilët që të gjithë i ka në flotën detare që lufton kundër flotës turke. Por ai është krenar veçanërisht me më të voglin, Anastasin, i cili drejton një nga anijet e atit të tij dhe që shquhet për trimëri të madhe"...

Kur del nga muzeu dhe hedh vështrimin nga deti e kupton se ky ishull jetonte dikur përmes heroikës së njerëzve të mëdhenj. Duke zbritur shkallët, ja dhe një shqiptar nga Berati që të thotë me krenari se gjatë dhjetë vjetëve aty janë vendosur 70 familje shqiptare të ardhura së fundmi, pas vitit 1990. Dhe ai, më shumë se kushdo nga ne shqiptarët, e ndjen sesa e rëndë është pesha e kufijve. Ishim në pragun e shtëpisë së dikurshme të Konduriotit, ndërkohë që përballë, njëqind metra më tutje, shikonim ndërtesën tjetër të Konduriotëve, akoma më madhështore.

Sigurisht, familja e Konduriotit ishte nga më të njohurat dhe nga më të vjetrat e ishullit. Historiani ynë i njohur Kristo Frashëri, duke iu referuar studimeve të Nik Haliorit të botuar në revistën "To mellon" 1935, nr. 9, f. 225, shkruante ndër të tjera se në një nga shkrimet e tij kujtohej se "Kundurioti fliste me kënaqësi të madhe gjuhën shqipe me ishullorët dhe se admirali, kur shkonte në Hidhra, përshëndeste përzemërsisht në të folmen arvanite gjithë peshkatrët e ishullit". Po në këtë botim grek, shkruhet: "Prifti hidhriot Athanas Kuluras 93-vjeçar, në gusht 2005 i tregoi T. Johallasit këtë dëshmi të shkurtër: Kur prifti ishte 18 vjeç (duhet të ketë qenë viti 1930 – K.F.) një hidhriot i tha të çonte në shtëpinë e Pavlo Kunduriotit një kornizë të re me fotografinë e Andrea Miaulit. Mbasi u përshëndetën, admirali e pyeti djalosin Kulura nëse dinte arvanitisht. – Jo, u përgjigj

Kulura. – E atëherë, çfarë hidhrioti je ti që nuk di arvanitisht? Ju të rinjtë nuk duhet ta përbuzni, – e qortoi gjenerali. Unë, – vazhdoi gjenerali, – edhe në kohën e luftës e të përleshjeve me kundërshtarët, me luftëtarët e mi flisja vetëm arvanitisht dhe i frymëzoja ata..." Po kështu, Frashëri na sjell dhe dëshminë e studjesit arvanitas Johallas mbi



gjuhën arvanitase, ku arvanitët e ishullit flisnin gjuhën shqipe: "Këtë çë të jap kártënë s'këjëm káqq hri t'e tërkónim (= dërgonim), se néve ja u shkrúaghmë gjithë ndë kártë, po për ngarkógh agh i ziv (i ziu është përkthim shqip i Mavro Kordhatos – Mavro = i ziu – K.F.), e dogh edhe Lurjoti, se u s'e dóghë, se i njoha lojiotati. U njoh këtë me të vghánë e atit Télit, çë isht i vghagh martuarë ndë Maltë e u bë tu dhjavólu. Mos jipni vesh ndë kártë sistatiki çë i kemi dhënë; áo çë thotë kártë jonë i dhiiqisit se ma shërbév di muagh pa mistró, áшту dogh áшту e bëm për t'e nxérim ka vétëhea. Një milë e pesëqint dumé na kostisi, rroba, kapelo, mamuze, këmishë, tirqi, vívlio, çë dogh ato bën, njeri i patu(rp)shëm. Néve trem-beshim t'i flasim ndënjë tetjo vent, mos vegh e thegh ki, e na havavegh shërbesi. Ruhuni ka lojiotatitë; amán ka kigh njeri, amán; i lig njeri. Të tháshë një milë e pesëqint e pesëqind dumé se na kostisi, maedhe di milë. Komitáto ma tha të bënim një ékthes për të shih pramëtë e Eládhësë; e dham t'e shkruan; e bëri. Pastagh nëkë mbet tropo të na e jip; u fandás t'e tipós vetë, e múar báshkë; káqë edhe më shumë".2

Pikërisht në Hidra, Specaj e Poros kishte jetuar për shumë vite studjuesi Carl Reinhold, i cili shërbente si mjek pranë marinës greke pas revolucionit. Por folklori i arvanitasve për të u kthye në një pasion të veçantë, duke mbledhur këngë popullore, për-ralla, fjalë të urta e legjenda, të cilat ndryshonin nga ato të grekëve. Madje ai i shkruante në një alfabet të çuditshëm ku në alfabetin me shkronja latine ndërhyjnë aty-këtu dhe shkronjat greke, apo germa të krijuara nga vetë ai. Ishin këngë dashurie, djepi, këngë humoristike që këndoheshin në raste festash familjare apo qytetare. "Mirë mbrömë, kunduriotë, Ishte vent të flëmë sonte? – Ishtë, po s'guconj nga mëma, – Se më nxe e vlen nga mbröma..."

Dorëshkrimin e tij, me një pjesë të folklorit arvanitas, Reinhold e botoi në Athinë në vitin 1855 nën titullin Netë pellazgjike (Noctes Pelasgicæ),3 çka është dhe e para përmbledhje mbi këngët dhe folklorin shqiptar në Greqi. Një pjesë e botoi albanologu gjerman Gustav Mayer, por pjesë të tjera të dorëshkrimeve të tij humbën në mugëtirën e kohërave.

"More re të zeza, Çë më sjell kakozezë, Mos më sjell burrenë Çë kam dëshiruarë..." Vallë ishin këngët e trishta të dramave dhe tragjedyve të hidriotëve në vitet e luftës e të mbi-

jetesës? Por një nga këngët më të bukura, ai e gjeti në gratë e ishullit fqinj Specaj, këngë që e kemi dëgjuar dhe në repertorin e këngëve popullore të Tefta Tashkos, pa e ditur se kjo këngë e vjetër na vinte nga arvanitasit e ishujve të Greqisë:

"Kur më vien burri nga stani puf, puf, puf më bön fustani, kur më vien burri nga klisha puf, puf, puf më bön këmisha, kur më vien burri nga ndara, dal e e pres me gas përpara..."

Në mbrëmje, lemë ishullit për të shkuar në bregun tjetër përballë, në Porto Xeli. Vështroja Hidrën me ëndje (Sidra, siç quhej në kohët e vjetra) e cila më largohej me të njëjtën pamje krenare. Dhe kështu mendoja atë kohë kur arvanitasit e parë në vitin 1460 kishin zbarkuar këtu në shkëmbinjtë e pabanuar në kohën kur bashkë me venecianët, shqiptarët luftonin kundër anijeve turke që donin të pushtonin ishujt e Greqisë... Aty kishte hedhur rrënjë një jetë shqiptare, e mbrujtur në gjuhë arvanite si dhe zakone e këngë që nuk janë shuar dhe në një lidhje të fortë greko-shqiptare... Mu kujtua Hidra e dashur, vendlindja e Jean Moreas4 të cilit i kisha kushtuar një libër, si dhe legjenda për të cilën shkruante Apollinaire "se një ditë, pas vdekjes, Jean Moreas hipur majë një kali, çante mes detit për të shkuar në vendlindjen e tij..."

Pra, tre vjet pas vdekjes së Moréas-it, Apollinaire do të pyeste në shtypin e kohës se "ç'bëhet rreth përmendores që do të ngrihej për Moréas-in në Paris". Ndër të tjera ai shkruante: "Sot në Amerikë ka një legjendë për Moréas-in. Këtë legjendë të hatashme, ma tregoi Frederic Boutet. Legjenda ishte botuar me shumë detaje në një gazetë amerikane. Po t'i besosh kësaj legjende, thuhet se Jean Moréas kishte vendosur të shkonte për të takuar miqtë, duke u kërkuar fotografitë e tij, me qëllim për t'i zhdukur ato. Pastaj kishte blerë një kalë të bardhë, me të cilin shkoi gjer në Dieppe, ku deti nuk e ndaloj, pasi ai shkoi drejt tij dhe hyri me kalë."5

Kjo legjendë nuk ishte thjesht një anekdotë. Së pari ajo tregonte se Moréas-i ishte bërë mjaft i njohur dhe në Kontinentin e Ri, në bregun tjetër të Atlantikut. Së dyti, imazhi i tij mbi kalë që humbiste drejt detit të pafund, tregonte për natyrën e vërtetë të Moréas-it, njeriut që kishte krijuar një legjendë rreth vetes dhe jetonte si në legjenda, pasi padyshim, ashtu do të kishte ëndërruar të ikte nga kjo botë, hipur mbi një kalë të bardhë, drejt një deti të pafund, të cilit aq shumë i kishte kënduar.

(Marrë nga Gazeta Shqiptare Online)



Table for crossword puzzle clues including categories like 'Autor: GAZMEND MORINA', 'AKTORJA DHE MODELJA AMERIKANE NË FOTO', 'PASANIKE', 'KËNGËTARE E NJOHUR SHQIPTARE', 'E MITUR', 'AKTORJA HOLLIVUDIANE', 'SHTRESË E SIPËR E AJRIT', 'NDODHI QË TREGOHET ME GOJË; TREGIM ME GOJË (krah.)', 'E TURPËROJ', 'BANORE E NJË SHTETI AFRIKAN', 'PREZANTUESE E NJOHUR SHQIPTARE', 'AZOT, URANIUM', 'QË JEP PEMË', 'ZANORE', 'LLOJ METALI INTERNATIONAL MARITIME ORGANIZATION', 'FUTBOLLISTI ITALIAN AMBROSINI "/>

SUDOKU grid with numbers: 3, 2, 4, 5, 2, 6, 5, 8, 9, 5, 4, 1, 7, 8, 3, 7, 4, 8, 6, 1, 3, 5, 9, 7

Main crossword puzzle grid with clues in various categories such as 'SASI E PRODHIMEVE QË MUND TË NXJERRË NJË FABRIKË', 'THARTIRA, THARTINA (kim.)', 'HUNDORËSI, MËNYRË E SHQIPTIMIT ME HUNDË TË TINGUJVE (ling.)', 'DIÇKA E FITUAR ME PUNË TË PANDERSHME DJALI KUNDREJT PRINDËRVE', 'LLOJ BIME NARKOTIKE (shq.)', 'FTOHJE E MARRËDHËNIEVE NDËRMJET DY SHTETEVE', 'FUTBOLLISTI PERUAN KLAUDIO (WERDER BREMEN)', 'MASHKULLI I PARË', 'KUSH', 'INTENSITET, TITAN', 'KATËRKËNDËSH (gjeom.) I SHËMTUAR (krah.)', 'HISTORIANI ROMAK LUKRECI', 'REGJISORI ... SOPI', 'VEGËL MUZIKORE ME FRYMË', 'AKTORI I FAMSHËM ... MARFI TË LUTEM (fet.)', 'FUTBOLLISTI ITALIAN IGNAZIO (MILAN)', 'KAFSHË QË MBAHET NË SHTËPI PËR NGARKESË (shq.) APROVIMI', 'E SHKALLËS MË TË ULËT A E ÇAKUT MË TË POSHTËM', 'LLOJ PESHKU ILAÇE', 'EMËR YNI MASHKULLI GJERMAN I VJETËR', 'QË LIDHET ME ORGANIN E TË PARIT QYTET UNIVERSITAR NË ANGLI (shqip. - shq.)', 'QYTET NË FRANCË (shqip.) QË ËSHTË LËNË I LIRË, PA FRE (vjet.)', 'BASHKËT. LLOJ VETURE FRANCEZE', 'ALUMIN DEGË E VEPRIMTARISË KRUJUESE ARTISTIKE', 'GURRA SHKRONJA TË NJËJTA', 'BISHË MALI SHKRONJA XXIV', 'KRIPË E ACIDIT NITRIK (kim.)', 'SHKRONJA XXVIII'

ZGJIDHJA E FJALËKRYQIT: E, MESELE; E KORTI, GAÑEZE, AMI, AR, N, S, FRUTOR, O, FENOMENAL, KROM, MASIMO, KANABISI, AMARETAT, AÇARIM, SD, ONAN, NA, PIZARO, ARD, CT, ADR, ADAMI, ANIE, AON, AI, CILI, BRITMA, NUN, ITI, KAM, AORTA, OJA, TETRAON, NOR, KRAF, BETER, ENDI, SABIT, A, TIT, ARDITA, PAMOR, EDI, KALI, REN, F, ABATE, DILETANT, AL, GOMARI, MIMOZA, AMA, MITARIMI, KANA, ARIU, MINIMALE, NITRAT, T. ZGJIDHJA E SUDOKUT: Kolona 1: 536 792 481; KII: 812 645 937; KIV: 721 536 894; KV: 695 481 723; KVI: 483 279 516; KVII: 247 863 159; KVIII: 359 127 648; KIX: 168 954 372.

'Selfie', 7 truke që duhet t'i ndiqni për një shkrepje të përkryer

Më 21 qershor u festua dita e vetëshkrepjes, konceptuar nga BBC në vitin 2014. Drita, vetullat, goja dhe inkuadrimi: rregullat për fotografitë që kapen nga kamera e përparme

Sot është Dita Botërore e Selfieve. Një festë me të vërtetë e veçantë - sigurisht moderne - që buron nga një ide e stacionit televiziv britanik. Në vitin 2014, BBC hap dyert e festës së vetëshkrepjes. Ishte periudha e krenarisë maksimale për kamerat e përparme, të shfrytëzuara në çdo mënyrë për të nxjerrë fytyrën prapa lentes. Por, sapo arti i selfieve u bë "zyrtar", - nga BBC por edhe nga Oxford English Dictionary, i cili prezantoi termin e ri në fjalorin e tij - është përkeqësuar papritmas, duke pësuar një rënie të ngadaltë. Natyrisht, sot ne të gjithë bëjmë fotografi, vetëm ose në shoqërinë e miqve. Por, le të themi se të paktën moda e "fytyrës duck" ose të tjera të ngjashme ka kaluar ngadalë plan në dytë. Sot, selfie është një foto si të tjerët, për të kapur një kujtesë, një udhëtim ose një moment. Thjesht, është një mjet i përshtatshëm për të qenë një pjesë - të gjithë, madje edhe ata që mbajnë smartphone - të kornizës. Edhe nëse është mirë, nuk është kaq e thjeshtë.

Ka nga ata që i urrejnë dhe ka të tjerë që i duan. Ka nga ata që shpenzojnë orë të tëra, duke shkrepur dhe nuk arrijnë të marrin një foto perfekte. Ka nga ata që stërviten çdo ditë në divan, duke komentuar postimet e shokëve në "Instagram". Por, edhe ata duhet të dorëzohen: nga 95 milionë fotografitë e postuara çdo ditë në rrjetin social, një pjesë e mirë merret nga kamera e përparme e smartphone. Selfie është një mjet i domosdoshëm, gjithashtu për shkak të investimit të prodhuesve të telefonave, të cilat pasurojnë kamerën e përparme me më shumë dhe më shumë pixels. Dhe nëse na pëlqen ose jo, duhet të mësojmë ta bëjmë mirë. Le të përpiqemi të përmbledhim disa këshilla në shtatë rregulla për t'u ndjekur.

Drita

Para së gjithash, burimi i dritës. Rregulli i përgjithshëm i fotografisë dëshiron që ajo të vijë nga prapa lentes, por në rastin e selfies - për të mos u verbuar - më mirë të poziciononi veten në mënyrë që të vijë anash. Pra, për



të nxjerrë në pah një pjesë të fytyrës. Gjëja e rëndësishme është që drita, - më mirë nëse është e natyrshme - arrijnë në fytyrën tonë dhe ndriçon sytë. Ndoshta pranë një dritareje. Përkundrazi, nëse doni një selfie më "sugjestive", sigurohuni që burimi i dritës të jetë një dhe të kontrollohet nga ju. Ashtu si një qiri apo një llambë e lehtë. Dhe kjo ju merr anash. Rregullojmë kornizën (ne do të shohim se si) dhe përdorim funksionin e dobishëm të smartphone që ju lejon të vendosni se ku të fokusoni zjarrin, duke shtypur me gishtin në pika të ndryshme në ekran. Mundësisht në fytyrën tonë, subjektin e vërtetë të fotos. Shmangni blicin: krijoni një dritë të panatyrshme dhe ngjyrosni ngjyrat.

Sytë

Sytë, thamë, janë qendra e selfieve dhe kështu që duhet të kontrollohet më shumë nga fytyra jonë. Është thelbësore që të fokusohemi në sensorin e kamerës: Sa shkrepje keni parë, ku protagonistët e portretizuar duket të shohin diçka interesante vetëm pas lenteve? Ose, në qoftë se nuk doni të rregulloni se kush do të shikojë foton, kthejeni shikimin tuaj diku tjetër dhe kthehuni në profil. Pastaj përqendrohuni te vetullat, për t'i rritur pak në mënyrë që sytë të duken më të

mëdha (pa granatim). Dhe përpiquni të "buzëqeshni me sytë tuaj" siç mësonte modelja Tyra Banks në programin e saj "American Next Top Model".

Goja dhe qafa

Për të arritur një efekt natyral, por pa shikuar si një model aspirues të mbuluar (me pak sukses), duhet të kontrolloni gojën. Via Face Duck - tani ata janë abuzuar dhe kështu kapërcyer, ata ju bëjnë të dukeni pak të butë në sytë e atyre që shikojnë figurën, - mendoni në vend që të hapni pak buzët. Dhe ndërsa po shkrepni, hidhni pak ajër. Pastaj përpiquni të shtrengoni qafën tuaj pak dhe të sillni shpatullat tuaja: fytyra juaj do të duket më e efektshme dhe do të jeni më të relaksuar.

Ku ta vendosni smartphonin

Le të kalojmë te pozicioni i smartphonin. Ndërkohë, mbani mend se sensorët janë kënd të gjerë, kështu që sa më afër që jemi, aq më shumë imazhi do të shtrembërohet. Më mirë ta mbani telefonin në një distancë "krah". Pastaj është mirë të sillni lenten pak më të lartë se perspektiva e syrit në mënyrë që të shmangni mendjet e dyfishta ose hundrat në shfaqje. Ka shumë

pak njerëz që rrinë mirë nga një perspektivë nga poshtë-lart dhe, në dyshim, më mirë të qëndrojnë te klasikja. Gjithashtu është më mirë të mos e vendosni smartphonin para nesh, por të rikuperojmë nga një kënd pak i zhdrejtë.

Ku ta poziciononi veten brenda kornizës

Sa i përket inkuadrimit, rregulli i palëve të treta është në fuqi. Ashtu si në të gjitha fotografitë, subjekti nuk duhet të vendoset në qendër të saktë. Ne duhet të ndajmë "drejtëndëshin" me dy linja vertikale dhe dy horizontale dhe të marrim kryqëzimet midis linjave si zjarri. Ja ku duhet të përmbushim shikimin tonë. Në rastin e selfies, natyrisht që fytyra jonë do të duhet të mbulojë pjesën më të madhe të shkrepjes (jo si në rastin më poshtë), por shtrihet në të djathtë ose në të majtë. Përveç nëse jeni duke bërë një ID foto për dokumentet. Pra, i kushtoni vëmendje sfondit - ndaluar rreptësisht banjo, pavarësisht nga ato pasqyra që gjithmonë tërheqin egon tonë - ose sigurohuni që, falë lojës së dritave, mbeteni të hutuar.

Si ta mbani smartphonin

Shumë e komplikuar, kur ju merrni një selfie, t'ia dalësh të

shtypësh butonin dhe ta mbani smartphonin në pozicionin e duhur në të njëjtën kohë. Ja një truk: vendosni telefonin horizontalisht dhe kapeni në anën e lartë me gishtin tregues dhe në anën e ulët me gishtin e vogël. Ju do të shihni se gishti i madh do të mbetet i lirë për të lëvizur për të shtypur, ndërsa ju do të mendoni se 'kurthi' në pajisje është provë e rënies.

Rregulli "sekret"

Selfiet më të njohura janë ato në grup. Me pushime ose në një pasdite me miqtë, për të festuar një mbrëmje ose gjatë një festë, gjithmonë vjen koha për të marrë pamjen në të cilën të gjithë duhet të jenë të pranishëm. Kështu që edhe ata që bëjnë shkrepjen, duhet të hyjnë në kornizë. Por mos harroni: ata që mbajnë smartphone në dorë do të jenë gjithashtu më afër lenteve dhe do të vuajnë shtrembërimet e këndit të gjerë, shumë më të theksuar në anët. Pikërisht aty ku zakonisht vendoset fytyra e tij, për të bërë vend për ata të të gjithë të tjerëve. Shkurtime, rregulli "sekret" gjithmonë hiq dorë nga telefoni. Sepse në qoftë se ne jemi të zgjedhur për të bërë selfien, ne gjithashtu do të jemi ata që vijnë pothuajse me siguri në mënyrë më të keqe.

(gazeta-Shqip.com)

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

ENGLAND - BELGIUM

GG

PANAMA - TUNISIA

3+

SENEGAL - COLOMBIA

2

Kosova rrëmben dy medalje të arta në Lojërat Mesdhetare

Dy xhudistet Nora Gjakova dhe Distria Krasniqi i kanë sjellë dy medalje të arta Kosovës Lojërat Mesdhetare "Tarragona 2018". Xhudistet pejane në finale triumfuan ndaj garuesve Gkohran Khelifi dhe Odette Giuffrida

PRISHTINË, 27 QERSHOR (ER) - Xhudoja vazhdon të jetë sporti kryesor në Kosovë, pasi garuesit e këtij sporti, Nora Gjakova dhe Distria Krasniqi, i kanë sjellë Kosovës dy medalje të arta nga Lojërat Mesdhetare "Tarragona 2018". Këto janë medalje historike, pasi Kosova për herë të parë merr pjesë në këto lojra.

Nora Gjakova në kategorinë -57 kg e mposhti maestralisht me Ippon garuesen nga Tunizia, Gkohran Khelifi dhe u kualifikua në finale. Në garë për medaljen e artë Nora u tregua garuese më e mirë se italiania Miriam Boi dhe me Ippon shënoi fitore. Ndërsa Distria Krasniqi në gjysmëfinale në kategoritë -52 kg mundi turken Irene



Korkmaz, pasi kjo e fundit u pezulua për shkak të tri vërejtjeve. Xhudistja pejane e mposhti në finale italianen Odette Giuffrida. Xhudisti Akil Gjakova në kategorinë -73 kilogramë është bartës i grupit të tij dhe në çerekfinale do ta presë fituesin e çiftit, J. Fernandes (Portugali) - J. Ramirez (Spanjë). Në kategorinë -63 kilogramë, konkur-



renca e femrave, Laura Fazliu përballlet në 1/8 e finales me serben Jovana Obradović. Akili dhe Laura garojnë të enjten. Garuesja e fundit që përfaqëson xhudon në "Tarragona 2018" është Loriana Kuka, e cila garon në -78 kilogramë. Shorti Lorianën e përballi me spanjollen Laia Talam Compano, kurse kjo përballje zhvillohet të premten.

Kosova në kualifikuese do të luajë për Gazmend Sinanin

Prishtinë, 27 qershor - Federata e Basketbollit të Kosovës (FBK) në një konferencë për medie i ka bërë thirrje publikut të jetë i pranishëm në numër sa më të madh në përkrahje të djelmohave të Kosovës, të cilët të enjten dhe dielën do të dalin në fushë dhe do të luajnë për Gazmend Sinanin, i cili ka ndërur jetë ditë më parë.

Në konferencën para ndeshjes kualifikuese për Kupën e Botës "Kina 2019" ndërmjet Përfaqësueses së Kosovës dhe asaj të Hungarisë, të pranishëm ishin kapiteni Dardan Berisha, basketbollisti Erjon Kastrioti, përzgjedhësi i Kosovës Brad Greenberg dhe kryetari i FBK-së, Arben Fetahu.

Ndeshja Kosovë - Hungari do të zhvillohet të enjten me fillim nga ora 20:30 në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë, ndërsa në të njëjtin orar do të luhet edhe të dielën takimi Kosovë - Poloni. "Jemi duke u përballur me një situatë shumë të vështirë emocionale. Po mendohe mi ta përballojmë, por nuk është aspak lehtë. Ne vetëm kemi dalë në fushë dhe e kemi zhvilluar stërvitjen e parë, s'ka qenë lehtë, sepse të gjithë kemi pasur emocione për faktin se dy javë kemi stërvitur së bashku me Gazin dhe lojtarët e tjerë që janë të lënduar. Në aspektin fizik dhe mental nuk jemi të përgatitur, por po bëjmë përpjekje që deri të enjten në mbrëmje, kur edhe do të luhet ndeshja, ta japim maksimu-



min për të hyrë në fushë dhe për të luajtur mirë për Gazin dhe për shtetin tonë", ka thënë Dardan Berisha, kapiteni i Përfaqësueses së Kosovës. "Shfrytëzoj rastin t'u bëj thirrje të gjithë adhuruesve të sportit të jenë në numër sa më të madh në palestër, sepse vërtet kemi nevojë për mbështetjen e të gjithëve", ka shtuar Berisha.

Ndërsa Brad Greenberg ka thënë se Kosova është duke kaluar nëpër një situatë të vështirë pas aksidentit që ndodhi në Gjakovë. "Mendimet tona janë me familjen e Gazit dhe të tjerë që janë lënduar në aksident. Pas aksidentit të gjithë kemi qenë në shok dhe nuk kemi menduar për basketboll. Ne kemi stërvitur për herë të parë dhe as paraqitja në parket nuk ka qenë e lehtë për të gjithë ne, veçanërisht për lojtarët. Të enjten kundër Hungarisë dhe të dielën kundër Polonisë do të mendohe mi të paraqitemi sa më mirë. Është e rëndësishme të theksoj se grupi po mendohe mi ta përballojë situatën duke qëndruar i bashkuar dhe lirisht mund të them se karakteri i grupit është vërtet i lartë. Do të bëjmë përpjekje të hyjmë në fushë

dhe të luajmë me shpirt, ashtu siç edhe Gazi e ka dashur jetën me plot shpirt. Këto janë momente të vështira për të gjithë ne, por vetëm kështu të bashkuar mund t'ia dalim", ka deklaruar përzgjedhësi Greenberg. Ndërsa kryetari i FBK-së, Arben Fetahu, ka deklaruar: "Rast të tillë si ky çfarë na ka ndodhur nuk ka pasur në të kaluarën as në radhët tona, as në ato të FIBA-s. Edhe pse kemi kërkuar që të mos luajmë, sepse në aspektin emocional nuk jemi në gjendje ta bëjmë këtë, FIBA na ka informuar se ndeshjet duhet të zhvillohen. Tani ne duhet t'i mbledhim forcat dhe t'i motivojmë djemtë tanë që të hyjmë në ndeshje dhe ta gjejmë forcën për të luajtur. Në aspektin e basketbollit, ekipi nuk është në gjendje të mirë, pasi kemi të lënduar nga aksidenti, pastaj të lënduar në stërvitje dhe kjo na e ka vështirësuar edhe më shumë situatën. Sidoqoftë, të enjten dhe të dielën në fushë do të paraqiten 11 lojtarë, ndërsa vendi i 12-të do të jetë për Gazmend Sinanin. Në të dyja këto ndeshje mendimet tona do të jenë me familjen e Gazit dhe të atyre që janë lënduar nga aksidenti. Në çdo ndeshje shikuesit janë shumë të rëndësishëm, këtë e dimë të gjithë, por kësaj radhe është diçka e veçantë, andaj ftojme opinionin që në numër sa më të madh të jenë në palestër për t'i përkrahur djelmohat tanë, sepse me të vërtetë këta janë heronjtë e kësaj ngjarjeje".

SHKURT

Rezultate jo të mira në tenis dhe atletikë

Tenisti Granit Bajraliu garoi në 1/8 e finales në Lojërat Mesdhetare "Tarragona 2018". Ai pësoi humbje 2:0 (6:2, 6:1) në sete nga bartësi i dytë i turneut, francezi Alexandre Muller. Të martën Graniti kishte shënuar fitore 2:0 në sete ndaj Mario Zillit të Shqipërisë. Ndërsa Vijona Kryeziu garoi në disiplinën 400 metra të atletikës, në Lojërat Mesdhetare "Tarragona 2018". Vijona doli e 14-ta nga 15 garuese. Ajo pati kohën 56.03 sekonda, duke mos arritur të kualifikohet në finale.

Lullaku përforcon Astran

Azdren Lullaku është rikthyer sërish në Rumani. Ai ka nënshkruar kontratë për skuadrën e Astra Giurgius. Sulmuesi shqiptar në edicionin e fundit ishte pjesë e skuadrës së Virtus Entela. 30-vjeçari dy sezona më parë ishte golashënuesi i ligës së dytë në Rumani, duke realizuar 16 gola në 20 ndeshje.

Ramosi, krenar që është spanjoll

Sergio Ramos nuk e fsheh dashurinë e tij për Spanjën, edhe pse mund të krijohet ndonjë ngacmim te katalanasit që janë përfshirë në kombëtare. Në profilin e tij në "Twitter" ai ka shkruar se "është krenar që vesh fanellën e Spanjës".

Bashkimi bëhet gati për garat ndërkombëtare

Kampioni i Kosovës në Basketboll, Bashkimi, pritet ta prezantojë Kosovën në edicionin e ri basketbollistik në garat evropiane. Me shumë gjasa, "Arpagjik" do të marrin pjesë në FIBA EuroCup, ku së fundi u paraqit Sigal Prishtina. Kjo ka bërë që të mobilizohet menaxhmenti i klubit si dhe komuna e Prizrenit, në mënyrë që të koordinohen sa më mirë para fillimit të garave evropiane. "Klubi ynë i zemrës, kampioni i Kosovës në basketboll, KB Bashkimi, sezonin e ardhshëm 2018/2019 me gjasë do ta prezantojë Prizrenin dhe Kosovën në gara të nivelit Evropian, FIBA Euro Cup! Pas takimit që menaxhmenti i KB Bashkimi zhvilloi me kryetarin e Komunitetit të Prizrenit u konfirmua vazhdimi i përkrahjes së Komunitetit të Prizrenit për kampionin, KB Bashkimi. Përkrahja institucionale në investime në palestër është konfirmuar nga MKRS-ja sikurse edhe përkrahja nga FBK-ja. Pjesëmarrja e KB Bashkimi në FIBA Euro Cup, përveç të tjerash, do të jetë një mundësi shumë e mirë edhe për bizneset prizrenase dhe kosovare që përmes sponsorimit t'i afirmojnë bizneset e tyre në nivel më të lartë për të hapur tregje të reja. Sporti, në këtë rast basketbolli, është një mundësi shumë e mirë për ta promovuar qytetin tonë të bukur si dhe tërë Kosovën! Të kontribuojmë secili në mënyrën e vet dhe në kuadër të mundësive që i kemi për t'i promovuar vlerat tona jo vetëm sportive!", thuhet në njoftimin e KB Bashkimi.

Messi: E dija se Zoti ishte me ne

Leo Messi është shprehur shumë i lumtur pas fitores ndaj Nigerisë (2-1) dhe kualifikimit nga grupi. Ai ka thënë se e dinte që Zoti ishte me Argentinën. "E dija që Zoti ishte me ne dhe ai s'do të na linte të binim tani nga grupi. Ne kishim besim se do të fitojmë këtë ndeshje. Ishte fantastike mënyra se si ia dolëm. Ne e merituar fitoren. Dua të falënderoj çdo tifoz të Argentinës që ka bërë sakrificat për të ardhur në Rusi. E falënderoj secilin prej tyre. Kombëtarja është mbi të gjitha", ka thënë Messi.

Sot zhvillohet ndeshja Europa FC - Prishtina

PRISHTINË, 27 QERSHOR - Pas fitores historike të kampionës së Kosovës në futboll, Dritës në Ligën e Kampionëve, fituesja e Kupës, Prishtina, sot (e enjte) do të luajë lojën e

parë në Ligën e Evropës. Prishtina ka bërë një udhëtim prej 21-orësh për të arritur deri në Gjibraltar, pasi të martën kishte fluturuar nga aeroporti i Tiranës drejt

Londrës, më pas nga kryeqyteti anglez drejt Gjibraltarit. Kundërshtarë e Prishtinës në këtë ndeshje është Europa FC, kurse ndeshja do të zhvillohet nga ora 18:00. Gjyqtarët

e ndeshjes do të jenë nga Portugalia, ndërsa delegati i ndeshjes nga Finlanda. Kjo është hera e dytë për "bardhekaltrit" që marrin pjesë në Ligën e Evropës.



Koreja eliminon Gjermaninë, kualifikohen Suedia dhe Meksika

Moskë, 27 qershor - Koreja e Jugut ka tejkaluar të gjitha parashikimet dhe e ka mposhtur 2-0 kampionen aktuale të Botës, Gjermaninë, e cila përfundon këtë Botëror si e fundit në Grupin F. Gjermanët e patën dominimin nga minuta e parë e deri në fund të ndeshjes, por assesi nuk arritën ta gjejnë rrugën e golit dhe këtë më së miri e shfrytëzuan lojtarët koreanë që realizuan dy gola. Një mungesë totale përqendrimi në minutën e parë shtesë në mbrojtjen gjermane, kur koreanojugorët përgatitshin të gjuanin një goditje nga këndi, bëri që Toni Kroos të jepte një "asistim" te sulmuesi kundërshtar që mposhti Neuerin. Jo vetëm kaq, por minuta e gjashtë shtesë vulosi makthin gjerman, kur shënoi Son për 2-0. Edhe pse u duhej vetëm një gol për ta siguruar kalimin në fazën e 1/8-ave të finaleve, kësaj here heroi Kroos kthehet në ndëshkuesin e kombëtares së "panzerave". Një



humbje tronditëse dhe një eliminim historik për gjermanët nga një Botëror. Ndërkohë Suedia ka treguar se disfata e sekondave të fundit ndaj Gjermanisë nuk ka ndikuar psikologjikisht duke mposhtur Meksikën me rezultatin e pastër 3-0. Pas një pjese të parë pa

gola, ishte Agustinsson ai që zhblokoi rezultatin në minutën e 50. Pas tij, kapiteni Granqvist dyfishon rezultatin nga pika e bardhë e penaltisë. Edhe një autogol i Alvarez fundos më keq Meksikën e pashpresë teksa suedezët sigurojnë kalimin në fazën e 1/8-ave.

Koreja eliminon Gjermaninë, kualifikohen Suedia dhe Meksika

Moskë, 27 qershor (ER) - Faza e grupeve në Kupën e Botës "Rusi 2018" përfundon sot (e enjte) me katër ndeshje, ku kryesorja do të jetë në mes të Anglisë dhe Belgjikës. Këto dy kombëtare janë paraqitur mirë në ndeshjet e para dhe tash luftojnë për pozitën e parë në Grupin G. Belgjika që në radhët e saj e ka edhe futbollistin shqiptar Adnan Januzaj është favorite në këtë ndeshje duke u bazuar në fondin e futbollistëve që posedon, por paraqitjet e anglezëve në dy ndeshjet e para të Botërorit bëjnë që fituesi në këtë ndeshje të jetë i paparashikueshëm. Ndeshja tjetër e këtij grupi është në mes të Panamas dhe Tunizisë, të cilat do të mundohen të përshëndeten me fitore në Kupa e Botës. Ndryshe nga ky grup, Grupi H është shumë interesant dhe tri skuadra janë në garë për kualifikim. Polonia është e eliminuar dhe do të luajë ndaj Japonisë që ka grumbulluar katër pikë, në anën tjetër Kolumbia është trimëruar pas fitores së fundit dhe synim ka fitoren ndaj Senegalit, e cila i mundëson kalimin në 1/8 e finaleve.



GRUPI G		GRUPI H	
20:00 Anglia - Belgjika		16:00 Japonia - Polonia	
20:00 Panama - Tunizia		16:00 Senegali - Kolumbia	
Tabela		Tabela	
1. Anglia	6 pikë	1. Japonia	4 pikë
2. Belgjika	6	2. Senegali	4
3. Tunizia	0	3. Kolumbia	3
4. Panamaja	0	4. Polonia	0

SHKURT / "RUSI 2018"

UEFA përjashton Milanin

UEFA ka suspenduar Milanin nga sezoni i ardhshëm i garave evropiane për shkak të shkeljes së rregullave për Fair-Playin Financiar. Sipas vendimit të UEFA-s, Milani dënohet për garën e ardhshme në të cilën arrin të kualifikohet brenda dy sezoneve të ardhshme (2018/19 apo 2019/20). UEFA ka njoftuar se Milani mund të ankohet në Gjykatën e Arbitrazhit.

Grezda: Në shtator do të jem gati për Shqipërinë

Eros Grezda ishte i ftuar në një lidhje në emisionin dedikuar Botërorit "Ruski Bar", në "Supersport 2", ku diskutoi jo vetëm për "Rusi 2018", por edhe për formën sportive. Sulmuesi gjakovar i Kombëtares shqiptare mungoi në miqësoret e qershorit për shkak dëmtimi, por tregoi se është shumë pranë rikuperimit të plotë dhe se do të jetë i gatshëm në shtator. "Rikuperimi ka ecur vërtet mirë. Kemi 10 ditë që kemi nisur përgatitjet në fushë dhe në muajin shtator do të jetë e sigurt që do të jem në dispozicion të Panuccit dhe Shqipërisë", ka deklaruar Grezda. Sulmuesi shqiptar është në qendër edhe të merkatos, pasi me shumë gjasa do të largohet nga kampionati kroat këtë verë, për të shkuar në një kampionat më të fortë. "Jam ende në fazë rikuperimi, por edhe merkatoja vijon. Duhet të jem në 100%, pastaj të shohim se çfarë do të na sjellë e ardhmja. Bundesliga është kampionati ku unë mendoj se do të ndihesha më mirë, por jam i hapur për një aventurë në kampionatet kryesore të Evropës", ka shtuar Grezda.

Sharapova: "Wimbledoni" i veçantë, këtu kam korrur suksesin e parë të madh

Tenistja ruse Maria Sharapova përgatitet për debutimin e saj në grandslemën e "Wimbledonit", me shpresën që të fitojë këtë turne të madh, i cili i mungon prej 14 vjetësh (e ka fituar në vitin 2004). Pas paraqitjes së mirë në Roland Garros, ku shkoi deri në çerekfinale, tenistja ruse synon të bëjë një hap më tej në fushat me bar të Londrës. "Jam mirë, jam përgatitur dhe kam disa ditë që ndodhem në Londër për t'u ambientuar me turneun e radhës", ka thënë Sharapova. "Është një turne i rëndësishëm për mua, ndaj nuk dua të zhgënej. Më pëlqen të luaj në fushat me bar, edhe pse e di se rivaliteti do të jetë i madh. Gjithsesi, nuk kam frikë nga asnjë teniste, pasi kam përvojën e duhur për t'ia dalë mbanë. Shpresoj të jenë dy javë të këndshme për mua në 'Wimbledon' dhe në fund të largohem me fitore", ka deklaruar Sharapova.

Shtohen problemet për Milanin, Mourinho kërkon Bonuccin

"Sunday Times" ka raportuar se Jose Mourinho kërkon t'i rrëmbejë Milanin kapitenin e saj, Leonardo Bonucci. Italiani, i ardhur nga Juventus sezonin e shkuar, ka fituar shumë reputacion në ambientin kuqezi dhe është tashmë një lider në ekipin e Gattuso. Vështirësitë ekonomike dhe mungesa e Ligës së Kampionëve është një faktor që portugezi Jose Mourinho kërkon ta shfrytëzojë dhe ta sjellë mbrojtësin në Manchester United. Milani me shumë gjasa do të ndërrojë pronësinë dhe, ndoshta, mund edhe të përjashtohet nga Liga e Evropës, çka nënkupton se kuqezinjtë e Milanit janë në kaos total.

Verratti kërkon largimin nga PSG-ja

Mesfushori italian, Marco Verratti, ka kërkuar largimin nga Paris Saint-Germain. Gjatë fundjavës "Mundo Deportivo" raportoi se PSG-ja ishte e hapur për ta shitur mesfushorin italian, kurse tash "Calciomercato" raportoi se dëshira për largim ekziston edhe tek Verratti. Faqja shpjegon se 25-vjeçari kërkon të nisë një aventurë të re pas takimit me trajnerin e ri Thomas Tuchel. Juventus, Manchester Unitedi, Real Madridi dhe Barcelona kanë treguar interesim për këtë futbollist.



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA



INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" - PRISHTINA
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" - PRIŠTINA

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore - Shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), Statutit të Institutit të Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë, neni 32, Këshilli shkencor në mbledhjen e mbajtur me date 26.06.2018 shpallë:

KONKURS

- 1 (Një) Bashkëpunëtor shkencor për periudhën e shek. XVI-XVIII-zgjedhje
- 1(Një) Bashkëpunëtor shkencor për periudhën e shek.XIX-XX - zgjedhje
- 1(Një) Bashkëpunëtor shkencor për periudhën e shek.XX - zgjedhje

1. Kandidati/ja për Bashkëpunëtor shkencor duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- Të ketë shkallën e doktorit të shkencave,
- Të ketë të botuar së paku një punim shkencor në ndonjë revistë relevante ndërkombëtare në kuadër lemisë,
- Të ketë marrë pjesë në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit,
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi.

Kandidati/ja duhet të dorëzojë dokumentacionin si vijon:

- Diplomën për përfundimin e studimeve përkatëse,
- Certifikatën e lindjes jo më të vjetër se gjashtë muaj,
- Dokument të lëshuar nga organi kompetent me të cilin dëshmohet që nuk janë nën hetime,
- CV të së cilës duhet t'i bashkëngjiten dëshmitë e nevojshme për të vërtetuar gjendjen e paraqitur në të.

Zgjedhja e personelit të Institutit të Historisë "Ali Hadri" bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore - Shkencore, dhe Statutit të Institutit të Historisë "Ali Hadri". Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në njërin nga gazetat ditore.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës për të cilin konkurrojnë.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor nga Instituti, dhe janë të obliguar të sjellin me vete dokumentet origjinale mbi kualifikimet dhe trajnimet e kryera për verifikim para Komisionit.

Për informata të hollësishme mund të kontaktoni në këtë nr. tel: 038/512 - 303, prej orës 09:00 - 16:00.

Aplikacionet e kompletuara dorëzohen në adresën: Instituti i Historisë në Prishtinë, rr. "Muharrem Fejza", pa numër (Ndërtesa e Arkivit të Kosovës).



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA



INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" - PRISHTINA
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" - PRIŠTINA

Prishtinë, 28.06.2018

Na osnovu Zakona br. 04/L-135 o naučnoistraživačkoj djelatnosti - (Službene Novine Republike Kosova , br 11/02 Maj 2013 .), Član 30 , Statuta Instituta za Istoriju " Ali Hadri " u Prištini , član 33 stav 5 , član 51 i 52 obavljuje :

KONKURS

- 1 (Jedan) Naučni saradnik za XVI-XVIII vekove - izbor
- 1 (Jedan) Naučni saradnik za XIX-XX vekove - izbor
- 1 (Jedan) Naučni saradnik za XX vekove - izbor

Kandidati za naučnog saradnika moraju ispuniti ove uslove:

- Da ima doktorske nauke, za navedeni period.
- Imaju najmanje jedan (1) naučnih rad objavljenih u relevantnim međunarodnim časopisima unutar oblasti,
- da su uspešno učestvovali u organizaciji naučnih aktivnosti.
- Poznavanje stranih jezika je prioritet.

Potrebna dokumentacija

Kandidat mora da dostavi sledeću dokumentaciju:

- Diplomu za završetak doktorskih studija,
 - izvod iz matične knjige rođenih koji nije stariji od šest meseci,
 - dokument izdat od nadležnog organa koji potvrđuje da nisu pod istragom,
 - CV o čemu mora priložiti neophodne dokaze kako bi se dokazala situacija u njoj.
- Izbor osoblja Instituta Istorija " Ali Hadri " bira se u skladu sa odredbama Zakona br . 04 / L - 135 za istraživačke-naučne aktivnosti - i Statuta Instituta Istorije " Ali Hadri " .

Rok za prijavu je 15 dana od dana objavljivanja u dnevnim novinama, Aplikaciji se prilažu (dodajte) kopije dokumentacije o kvalifikaciji, iskustvu i drugoj potrebnoj dokumentaciji koju zahteva radno mesto za koje se aplicira.

Kandidati izabrani na izbornoj listi će biti obavešteni u pisanom obliku ili putem telefona u zakonskom roku Instituta i dužni su da sa sobom daju originalne dokumente o kvalifikacijama i obuci koja se provode za verifikaciju pred Komisijom.

Za detaljnije informacije možete se obratiti na ovom Br . Tel: 038 / 512 303, od 09:00 do 16:00 časova.

Kompletirani zahtevi dostavljaju se na adresu : Institut Istorije u Prištini , ul. " Muharrem Fejza " bez broja (Zgrada Kosovske Arhive)


Shijo Pranverën me...

Jaffa Champion PLUS A+C+E Multifrutti

Taste of World Wide Brand!

2L

Jaffa Champion


SH.E.K.
QENDRESA KOSOVARE

Data: 27/06/2018 Nr: / /

Ftesë për ofertë


Shoqata Ekonomiko Kulturore "Qendresa Kosovare" Prishtinë me nr të regjistrimi 5111402-7 dhe nr fiscal 601759452.


Në mbledhjen e mbajtur më 25.06.2018 e hënë ka vendosur që :
Të hap mundësin e ofertimit për konkurim në ndërtimin e fshatit social.

Kriteret

Të jenë të regjistruara në MIT,
Të prezantoj vërtetim nga Gjykata ekonomike se nuk ka problem me ligjin,
Të jenë kompani serioze,
Të jenë profesionalizuar në ndërtim,
Të sjell referenc për punën e kryer deri më tani,
Kompanit nga rajoni që do ndërtohet kanë prioritet.

Oferta është e hapur nga data 28.06.2018 deri më 29.06.2018.





Adresa: Kosovë / Prishtinë 10 000 / Rr. Shefqet Shkupi / Kalabri 1
Email: gendresakosovare@gmail.com Tel: 0038344156788

C.nr.147/18

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE-DEGA NE VUSHTRRI, si kontestimore e perbere nga gjykatesi Individual Besnik Feka, ne çeshtjen juridike te paditsit Bajram Krasniqi nga fshati Begaj, Komuna e Vushtrrise, te cilin me autorizim e perfaqeson avokate Kada Bunjaku Perçuku, kunder te paditures Arbnora Krasniqi e vajzerise Halili, nga Vushtrria, tani me adrese te panjohur, gjykata jashte seances me daten 27/06/2018, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

I. Te paditures Arbnora Krasniqi e vajzerise Halili nga Vushtrria, tani me adrese te panjohur i caktohet perfaqesuesi i perkohshem av. Kamer Cakaj nga Vushtrria.

II. Shpenzimet per caktimin e perfaqesuesit te perkohshem i barte paditesit.

A r s y e t i m

Paditesi Bajram Krasniqi nga fshati Begaj, Komuna e Vushtrrise, ka parashtuar padi per zgjidhje te marteses, kunder te paditures Arbnora Krasniqi e vajzerise Halili nga Vushtrria, tani me banim te panjohur per gjykatën, prandaj, gjykata, duke u bazuar ne nenin 79, par.3 te LPK-se, vendosi si ne dispozitiv te ketij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE-DEGA NE VUSHTRRI
C.nr.147/18, dt. 27.06.2018

G J Y K A T E S I
Besnik Feka

UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kunder ketij aktvendimi, nuk lejohet e drejta ne ankese.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Shpat Spahi shpall te pavlefshme certifikatën e maturës shtetërore Loyola Gymnazium
- ▶ Mehdi Berisha shpall te pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren.
- ▶ Unë Arberesha Behluli, shpallë të pavlefshme diplomën Bachelor, e diplomuar ne vitin 2015, në drejtimin: Menaxhment dhe informatike, Fakultetin Ekonomik, në Kolegji AAB.
- ▶ Lëshoj me qira banesën në Prishtinë, Lagja Mati 1, rr. Ndue Perllashi (pas 13 katshes). Banesa ka 58 m. katrorë, e mobiluar. Nr. kontaktues 044-121-668 ose 044-172-938. Çmimi sipas marrëveshjes.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Fushë Kosovë, për një familje 3 anëtarësh. Banesa duhet të ketë 2 dhoma gjumi, dhomë dite, kuzhinë dhe poashtu të jetë e mobiluar. Banesa kërkohet për afat më të gjatë. Info në tel: 044-741-151
- ▶ Urgjentisht kërkoj banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhome gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155
- ▶ Urgjentisht kërkoj banesë me qira ne Prishtinë, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhome gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155
- ▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.
- ▶ Lëshoj me qira banesën tri dhomeshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958
- ▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.
- ▶ Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.
- ▶ Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783
- ▶ Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ar, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira kati i parë , në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info: 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtër. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- ▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- ▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- ▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobilave "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.
- ▶ Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.
- ▶ Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.
- ▶ Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.
- ▶ Kërkoj dy bashkëbanuese, mundësisht të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përball Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së, ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesën mund ta shiheni çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.
- ▶ Shesim banesën dy dhomeshe në Ulpiana D8 h3 Nr 15 kati 3 ndërtim i vjetër, e rinovuar komplet, me nxemje të qytetit , çmimi 77 000€. Informatat tel:049/400-958 dhe 044/627-387
- ▶ Lëshoj banesën e pamobiluar (garsonierë) me qira. Banesa, e cila gjendet rrugës për në Gërmi, 150 metra afër Kolegjit Amerikan A.U.K, ndodhet në katin 5. Çmimi 130 euro. Tel: 049/705-503 dhe 049/662-211.
- ▶ Lëshoj garsonierën me qira 13 m2 kati i IV (katër) në Lagjen Ulpiana. Çmimi 150 euro. Për info: 044/637-546.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Ulpiana objekti C7 kati i 3 hyrja e II-të nr 11 ka 50 m2 dy dhomshe , një banjo, kuzhinë të gjitha të reja, është e përshtatshme për zyre edhe apo ordnancë. Për informata nr tel; 044/641-524 dhe + 46705793508.
- ▶ Kërkoj punëkryes për ndërtimin e serrës 4000 metra katrorë. Shefqet Shala, B.I.-Skenderaj. Tel.044-499-713.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gasensas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

**Afati i paraqitjes prej 03.03.2018
deri më 10.03.2018**

Ju mirëpret:

Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333